

Programi Kombëtar i Modernizimit të Sektorit të Ujësjetës-Kanalizimeve në Shqipëri

Vlerësimi i Sistemeve Mjedisore dhe Sociale

Janar 2022

Tabela e përmbajtjes

Shkurtesa.....	4
Përmbledhje ekzekutive	6
Seksioni I. Përshkrimi i Programit.....	14
Seksioni II. Përshkrimi i Efekteve të Pritshme Mjedisore dhe Sociale të Programit	17
Efektet e mundshme MS	17
Përfitimet MS	17
Ndikimet negative MS	17
Faktorët Kontekstualë të Riskut	19
Risqet e Kompleksitetit dhe Kapaciteteve Institucionale.....	20
Risqet Politike dhe të Reputacionit.....	20
Seksioni III. Vlerësimi i Sistemeve të Menaxhimit Mjedisor dhe Social të Huamarrësit lidhur me Programin	22
Sistemi i Menaxhimit Mjedisor	22
Sistemi i Menaxhimit Social	28
Përmbledhje e Vlerësimit të Kapaciteteve të Institucioneve të Programit për të Zbatuar Sistemin e Menaxhimit të M&S të Programit.....	33
Vlerësimi i masës së përputhshmërisë së sistemeve të zbatueshme me parimet themelore dhe elementet kyçe të planifikimit.....	35
Seksioni IV. Rekomandime dhe Veprime	45
Informacion për Planin e Veprimit të Programit (PVP)	45
Sistemet Kyçe dhe Mangësitë në Performancë.....	45
Veprimet e Rekomanduara në Kudër të PVP-së	46
Elemente të tjera të propozuara për të trajtuar rreziqet	49
Informacione për Planin e Mbështetjes së Zbatimit të Programit	50
Seksioni V. Shtojca Mbështetëse dhe Dokumente Reference.....	52
Shtojca A e Përditësuar: Hartëzimi i Palëve të Interesit.....	53
Fusha e Rezultateve 1: Kuadër i Përforcuar Kombëtar, që do të përqendrohet në kuadrin e sektorit kombëtar dhe në politikat dhe programet kombëtare.	53
Fusha e Rezultateve 2: Efektshmëri dhe Qëndrueshmëri Financiare e Përmirësuar e Ndërmarrjeve të UK-së	54
Fusha e Rezultateve 3: Akses i Përmirësuar në Shërbime të Furnizimit me Ujë në Zonat Rurale	56
Shtojca B: Shembull i Formularit të Ankesës në Portalin Kombëtar të Konsumatorit.....	1
Shtojca C: Plotësimi i Propozuar me Personel MS për Njësinë e Zbatimit të AKUM, Përshkrimi i Pozicionit	3

Shtojca D: Pyetëson i Kontrollit i Ndërmarrjes së Ujësjetlësit dhe Bashkisë	5
PYETËSOR për Ndërmarrjet e Ujësjetlësit, Programi “PpR për Ujin në Shqipëri”	5
Shtojca E: Palët e konsultuara gjatë përgatitjes së VSMS-së.....	10

Shkurtesa

AKUM	Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve
PP	Personat e Prekur
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
TLD	Treguesi i Lidhur me Disbursimin
MS	Mjedisor dhe Social
VSMS	Vlerësimi i Sistemeve Mjedisore dhe Sociale
ERRU	Enti Rregullator i Ujit
BE	Bashkimi Evropian
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
QSh	Qeveria e Shqipërisë
MTA	Mekanizmi i Trajtimt të Ankesave
KFW	Kreditanstalt für Wiederaufbau
KKT	Këshilli Kombëtar i Territorit
BTR	Blerja e Tokës dhe Risistemimi
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
UPA	Ujë Pa të Ardhura
PKMSUK	Programi Kombëtar i Modernizimit të Sektorit të Ujësjetllës-Kanalizimeve
OZhp	Objektivi i Zhvillimit të Programit
PpR	Programi për Rezultate
NjZP	Njësia e Zbatimit të Projektit
ZM	Zonë e Mbrojtur
FR	Fusha e Rezultateve
DRTK	Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore
VMS	Vlerësimi Mjedisor Strategjik
SHUKALB	Shoqata Ujësjetllës Kanalizime e Shqipërisë
PSO	Procedurat Standarde të Operimit

US\$	dollarë amerikane
GBB	Grupi i Bankës Botërore
PISU	Projekti i Investimeve në Sektorin e Ujit
UK	Ujësullës-Kanalizime
NU	Ndërmarrja e Ujësullës
ITUN	Impianti i Trajtimin të Ujërave të Ndotura

Përmbledhje ekzekutive

1. Objektivat e Zhvillimit të Programit (OZHP) për Programin Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Ujësjetës-Kanalizimeve në Shqipëri (P170891) janë: i) forcimi i incentivave dhe kapaciteteve institucionale në nivel qendror dhe vendor për performancë të përmirësuar institucionale dhe financiare të ndërmarrjeve të UK-së; dhe ii) rritja e aksesit në shërbime të ujësjetës të menaxhuara në mënyrë të sigurt në Shqipëri.

2. Operimi konsiston në një komponent të Financimit të Programit për Rezultate të Bankës Botërore (BB) dhe në një komponent të Financimit të Projektit të Investimeve. Instrumenti i Financimit të PpR-së u prezantua nga Banka Botërore në vitin 2012 për të përmirësuar efikasitetin e zhvillimit, me qëllim shtimin e vëmendjes së financave për zhvillim të rezultatit; ndihmesën në ngritjen e sistemeve të klientit; dhe bashkërendimin e platformave në vend. Operacionet e PpR-së mbështesin programet e qeverisë për shpenzimet (në nivel sektori/nënsektori, kombëtar/nënkombëtar) me objektiva të përcaktuara dhe rezultate që mund të jenë të reja ose në vazhdim. Financimi i PpR-së lidh disbursimet me arritjen e treguesve të rezultateve që janë të prekshme, transparente dhe të verifikueshme, të njohura si Treguesit e Lidhur me Disbursimin (TLD-të). Financimi i PpR-së përjashton aktivitetet që gjykohen se kanë ndikime negative të konsiderueshme që janë të ndjeshme, të larmishme ose të paprecedenta për mjedisin dhe/ose personat e prekur.

3. Ky Vlerësim i Sistemeve Mjedisore dhe Sociale (VSMS) është përgatitur nga Grupi i Bankës Botërore për këtë operacion në përputhje me Politikën e Bankës dhe Financimin e Programit për Rezultate të Direktivës së Bankës. Si pjesë e VSMS-së, ekipi i caktuar i BB-së i vlerëson Sistemet e Programit PpR lidhur me menaxhimin e efekteve mjedisore dhe sociale, duke marrë në konsideratë, ndër të tjera, kapacitetet për të planifikuar, zbatuar, monitoruar dhe raportuar për masat zbutëse mjedisore dhe sociale, fushëveprimin për përmirësime, dhe risqet e masat zbutëse përkatëse.

4. Programi PpR është kombëtar për sa i përket mbulimit gjeografik, duke mbështetur objektivat e përzgjedhura strategjike të Strategjisë Kombëtare të UK-së së Qeverisë së Shqipërisë. Programi PpR do të përqendrohet në tre Fusha të Rezultateve dhe aktivitetet shoqëruese që do të mundësojnë arritjen e OZHP-së:

- a. **Fusha e Rezultateve 1 (FR1) – Kuadër Kombëtar i Forcuar**
- b. **Fusha e Rezultateve 2 (FR2) – Performancë e Përmirësuar Operacionale dhe Financiare e Ndërmarrjeve të UK-së**
- c. **Fusha e Rezultateve 3 (FR3): Mbyllja e hendekut drejt aksesit universal në shërbimet e ujësjetës.** Disbursimet e financimit bëhen përmes TLD-ve. Këto të fundit strukturohen përreth katër fushave të rezultateve dhe shërbejnë si gurë kilometrikë në arritjen e objektivave zhvillimore të Programit PpR.

5. Gurët kilometrikë

Fusha e Rezultateve 1: Kuadër i Forcuar Kombëtar i Sektorit	Shpenzimet, aktivitetet dhe rezultatet e pritshme për përmirësimin e mjedisit të përgjithshëm mundësues për ofrimin e shërbimit në nivel kombëtar dhe vendor nëpërmjet përmirësimit të mekanizmave të financimit të sektorit, kapaciteteve institucionale dhe sistemeve të informacionit (Masat Prioritare sipas <i>Objektivave Strategjike Nr. 1, 5 dhe 6</i> të Strategjisë Kombëtare Sektoriale të
---	---

	Ujësjiellës-Kanalizimeve 2019-2030 (SKS)
Fusha e Rezultateve 2: Performancë e Përmirësuar Operacionale dhe Financiare e Ndërmarrjeve të UK-së	Fokuset në performancën e përmirësuar operacionale dhe financiare në nivelin e agreguar kombëtar, që sjell cilësi të përmirësuar të shërbimit (monitorimi i cilësisë, presioni, vijimësia, vëmendja ndaj konsumatorit dhe kthimi i përgjigjeve ndaj tyre), eficiencën operacionale (eficiencia e energjisë, eficienca tregtare, UPA-ja) dhe realizueshmërinë financiare/rikuperimin e kostove . Burimet për t'u kanalizuar sipas tre zërave buxhetorë: <ul style="list-style-type: none"> - Grantet e Bazuara në Performancë (GBP) me komponentin e pandryshueshëm dhe të ndryshueshëm – kombinimi i subvencioneve aktuale operacioneve me alokimet e bazuara në performancë për “projektet e vogla”. Për vitin 2020, këto përfshijnë mbështetje financiare për rimëkëmbjen nga pandemia e COVID19; - Projekte të pranueshme të Eficiencës Operacionale dhe Cilësisë së Shërbimit (Eficiencia Tregtare, Eficiencia e Energjisë, reduktimi i UPA-së, Eficiencia e stafit, 24/7 dhe të tjera – siç përfshihen në Planin e Biznesit/Planin e Përmirësimit të performancës dhe bazuar në Vlerësimin Vjetor të Performancës); - Granti i Incentivave për NjQV-të/UK-të që i bashkohen proceseve të reformimit/rajonalizimit.
Fusha e Rezultateve 3: Mbyllja e hendekut drejt aksesit universal në shërbimet e ujësjiellësit	Akses i përmirësuar në shërbime të sigurt dhe të besueshme të furnizimit me ujë në zonat me shërbim të pamjaftueshëm. Nëpërmjet krijimit të një dritareje të re të financimit brenda AKUM-it për investime nga NjQV-të/ndërmarrjet e UK-së në zonat me shërbim të pamjaftueshëm që shënjestrojnë aksesin e përmirësuar në shërbimet e ujësjiellësit në këto zona. Pritet bashkëfinancim nga NjQV-të.

6. Procesi i përgatitjes së VSMS-së parashikon konsultim me palët e interesit. Gjetjet kryesore të evidentuara nga Palët e Interesit janë si më poshtë:

- a. Dialogë të shumtë me qeverinë dhe ministritë e linjës, konkretisht MFE dhe MIE;
- b. Konsultim me agjencitë qeveritare në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor që kanë lidhje me sektorin e UK-së;
- c. Konsultime me njësitë e mundshme përfituese, duke përfshirë bashkitë, ndërmarrjet e ujësjiellës-kanalizimeve, bordet e drejtorive të ujësjiellësit dhe përfaqësuesit e tyre;
- d. Konsultime me Agjencinë Kombëtare të Ujësjiellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM);
- e. Takime me Entin Rregullator të Ujit (ERRU);
- f. Konsultim me institucionet ose organizatat aktive;
- g. Komunikim dhe takime me donatorë të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë që punojnë në sektorin e UK-së (SShÇE, BE, FShZh, GIZ, KFW, etj).

7. Ky është një version paraprak i VSMS-së që nuk përfshin komente nga prezantimi dhe shpërndarja e versionit përfundimtar, por përfshin komente dhe feedback nga të gjitha konsultimet e zhvilluara gjatë përgatitjes, dhe ky version gjysmëpërfundimtar po i vihet në dispozicion publikut dhe po iu shpërndahet palëve të interesit për çdo pyetje të mëtejshme, koment ose feedback nga vetë ata dhe publiku i gjerë.

8. **Përfitimet, Risqet dhe Ndikimet Mjedisore:** Përfitimet mjedisore përfshijnë ruajtjen e mundshme dhe zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit ujor, përmirësimi i ekosistemeve akustike, ose përputhshmërinë me objektivat kombëtare, rajonale dhe/ose vendore mjedisore dhe të planifikimit. Një nga pikat shqetësuese është se pjesë të caktuara të rrjetit të ujësjiellësit mund të jenë ndërtuar me tuba asbest-çimentoje dhe nevojiten dispozita të veçanta për trajtimin dhe menaxhimin e tyre. Rehabilitimi i rrjetit të shpërndarjes së ujësjiellësit do të shoqërohet me përmirësimin e shërbimit të ujit të pijshëm. Kjo do të nxisë zhvillimin ekonomik dhe mund të mbështesë zhvillimin e bizneseve vendore. MIE dhe AKUM kanë shprehur interes në forcimin e mbulimit dhe komunikimit për programin e mbrojtjes sociale që subvencionon koston e lidhjeve

në ujësjellës dhe të matësve. Ky aktivitet do të mbështetet nga komponenti i Financimit të Projektit të Investimeve (FPI).

9. Ndikimet dhe risqet kryesore sociale lidhen me aktivitetet e ofrimit të shërbimit sipas fushave të rezultateve 2 dhe 3. Përmirësimi i aksesit, cilësisë dhe efikasitetit të ofrimit të shërbimit të UK-së si aktivitete janë parashikuar që të sjellin rezultate, të cilat përfshijnë rritjen e pjesëmarrjes së komunitetit dhe investimeve në infrastrukturën e re dhe rehabilitimin e asaj ekzistuese. Megjithëse rehabilitimi nuk ka gjasa të sjellë ndikime sociale negative në përmasa të mëdha, investimi në zgjerimin e rrjeteve të furnizimit me ujë mund të kërkojë akses ose blerje të përkohshme ose të përhershme lineare të tokës në përmasa të vogla. Ndikimet për nënprojekt nuk pritet të prekin më shumë se 100 individë. Nuk pritet që blerja e tokës, nëse do të ndodhë, të shkaktojë ndërhyrje në mjetet e jetesës së personave të prekur. Megjithëse punimet kryhen zakonisht përgjatë rrugëve që janë nën juridiksionin e bashkive, ekziston mundësia për blerjen e përhershme të tokës gjatë zgjerimit të lidhjeve në ujësjellës dhe ndërtimit të objekteve të reja të ujësjellësit. Përvojat e bashkive për blerjen e tokës lidhur me njoftimin dhe kompensimin e duhur kanë qenë të përziera. Për më tepër, sipas kodit të ujit, pika 3.6 për "Për kostot dhe tarifat për punimet në sistemin e ujësjellësit në objekte private", për ndërtimin e rrjetit shpërndarës së ujësjellësit në një pronë private përmendet se dikush që kërkon të ketë një lidhje në sistemin publik të ujësjellësit është i detyruar të paguajë shpenzimet përkatëse. Po ashtu, në pikën 3.7 për rilidhjen në tubacion, konsumatori do të paguajë tarifën e llogaritur për koston e materialeve të përdorura, ku përfshihen shpenzimet për vendosjen e tubacionit, adaptorëve, matësve të ujit, etj. Kostoja për këto aktivitete që varion nga 1,200 euro në 2,600 euro¹ mund të jetë pengues për familjet me të ardhura të ulëta. Gjithashtu, sipas fushës së rezultateve 2, megjithëse agregimi i ndërmarrjeve të UK-së ka gjasa të shënojë përmirësime në performancë çka do të sillte përfitime shoqërore, risqet e mundshme lidhen me incentivat e palëve të interesit dhe prioritetet kundërshtuese

10. **Vlerësimi i Sistemeve Ekzistuese të Menaxhimit të Riskut Mjedisor:** Shoqëritë/ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve nuk kanë specialistë mjedisi në përbërjen e stafeve të tyre. NU-të kanë tendencën të kenë një person përgjegjës për shëndetin dhe sigurinë, por zakonisht ky pozicion mbulohet nga kryeinxhinieri. Në rastet kur NU-të kanë fonde kontraktohet një shoqëri e specializuar (p.sh. NU Durrës). Sipas ligjit, inxhinierit/shoqërisë së kontraktuar i kërkohet të ofrojë trajnime dhe japë udhëzime lidhur me çështjet e shëndetit dhe sigurisë të paktën një herë në vit, dhe ky proces duhet të dokumentohet. Parakusht për marrjen e një leje ndërtimi është miratimi mjedisor, dhe gjatë dy viteve të fundit ka pasur një rritje në dhënien e miratimit të duhur mjedisor, bazuar në ndryshimet administrative që ndodhën. Për rrjedhojë, po ndërmerret një nivel i caktuar i kujdesit të duhur mjedisor. Një hendek madhor është fakti që legjislacioni kombëtar kërkon vetëm plane rehabilitimi në fund projektit, por jo Plan të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS). Identifikimi i risqeve dhe rëndësia e ndikimeve sipas standardeve kombëtare është një tjetër fushë ku nevojitet përmirësim. Legjislacioni kombëtar ka një set të përcaktuar parametrash që duhen monitoruar, por procesi kërkon ende përditësimin e dokumentacionit dhe përfshirjen e një analize bazë të të dhënave. Menaxhimi i integruar i burimeve ujore nuk respektohet në mënyrë periodike. Për sa i përket menaxhimit të tubave prej asbesti, zakonisht NU-të nuk kanë protokolle për menaxhimin e sigurt të tubave prej asbesti gjatë punimeve ndërtimore dhe shkatërrimin e këtyre tubave. Po ashtu, edhe MIE nuk

¹Protokolli i brendshëm i hartuar nga ERRU, dhe i zbatuar nga NUK-të. Kostot janë të përafërta.

ka një protokoll për shqyrtimin e investimeve që mund të përfshijnë tuba prej asbesti, dhe të dhënat lidhur me shpërndarjen e tubave në rrjetet e ujësjellësit në mbarë vendin nuk janë lehtësisht të disponueshme.

11. Për sa i përket monitorimit të cilësisë së ujit, legjislacioni kombëtar i kërkon Institutit të Shëndetit Publik të kryejë kontrolle të cilësisë së ujit dhe ndërmarrjeve të ujësjellësit të kryejnë testime të cilësisë së ujit. Që të dyja, Instituti i Shëndetit Publik dhe ndërmarrjet e ujësjellësit përballen me kufizime në burimet njerëzore për realizimin e këtyre detyrave.

12. Për shkak të faktit se ka shumë humbje të ujit pa të ardhura në rrjetet e vjetra të ujësjellësit, të shkaktuara nga rrjedhjet në tubacionet kryesore me presion të lartë, si dhe lidhjeve të mundshme të paligjshme, në shumicën e rasteve NU-të janë të detyruara të prodhojnë më shumë ujë sesa sasia që programuar për të mbuluar humbjet në rrjet. Kjo rrezikon qëndrueshmërinë e burimeve ujore. Sipas Udhëzuesit të Bankës Botërore për VSMS-në, kërkohet forcimi i punimeve shoqëruese ndërtimore dhe përmirësimi i menaxhimit të ndikimeve mjedisore shoqëruese. Për sa i përket rrjeteve rurale të ujësjellësit që janë pjesë e Programit, duhet të ndërmerret përforsim shtesë për të garantuar ndikime minimale në zonat natyrore, habitatet e mundshme natyrore, pyje ose zona të tjera që mund të jenë të ndjeshme, dhe në këtë fazë, të nënzhvilluara. Si rrjedhojë e risqeve dhe aspekteve të kapacitetit të trajtuara më sipër, risku i përgjithshëm mjedisor lidhur me Programin vlerësohet i konsiderueshëm.

13. **Vlerësimi i Sistemeve Ekzistuese të Menaxhimit të Riskut Social.** Sistemet për menaxhimin e risqeve sociale lidhur me zhvillimin e rregulloreve të reja, siç është metodologjia për vendosjen e tarifave, janë të mirëthemeluara. Ekziston një praktikë e zhvillimit të dëgjësive publike për ligjet e reja. Po ashtu, ekzistojnë edhe mekanizma të ankesave në nivel kombëtar dhe të ndërmarrjeve të UK-së, në nivel MIE dhe ERRU. Me mbështetjen e GIZ-it, sistemi i ankesave u përfshi në Portalin e Shërbimit të Klientit, i cili është në proces prezantimi për Ndërmarrjet e UK-së. Kur blerja e tokës kërkohet për punime ndërtimi, menaxhimi i riskut social mundësohet nga njësia e zbatimit të projektit, zakonisht bazuar në udhëzimet subjektit që ofron financimin. Lidhur me projektet e financuara nga fondet e qeverisë shqiptare, procedura e shpronësimit përshkruhet në ligjin shqiptar për shpronësimet, i ndryshuar me Ligjin Nr. 20/2016, datë 10.3.2016. Ky ligj rregullon të drejtën e shtetit për të shpronësuar ose për të marrë në përdorim të përkohshëm për interes publik pasuritë e personave fizikë ose subjekteve juridikë, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të pronarëve përkatës.

14. Ligji njih të drejtën e kompensimit vetëm për personat e prekur (PP) që kanë të drejta ligjore zyrtare. Gjithashtu, legjislacioni shqiptar nuk njih humbjen e mjeteve të jetesës lidhur me blerjen e tokës. Në rastet kur PP-të janë identifikuar por nuk janë pronarë të ligjshëm, ofrimi i një zgjidhjeje të përkohshme ose marrëveshjeje varet nga vullneti dhe kapacitetet e bashkive. Ligji shqiptar për shpronësimet nuk ofron kompensim në natyrë, dhe rrjedhimisht nuk kërkohet ofrimi i strehimit të duhur me sigurinë e të drejtave mbi burimet. Kompensimi ofrohet bazuar në vlerën monetare, dhe çmimet janë publikuar në VKM Nr. 89, datë 03/02/2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë". Çmimet e prezantuara për njësi për shpronësimet janë përgjithësisht nën vlerën e tregut. Duke qenë se çmimet i përkasin vitit 2016, ato nuk janë domosdoshmërisht të mjaftueshme për blerjen e pasurive zëvendësuese me vlerë të barasvlershme dhe për të paguar shpenzimet e nevojshme të përkohshme. Përveç njoftimit të PP-ve, nuk ka asnjë kërkesë për konsultimin dhe prezantimin publik të dokumentacionit. Legjislacioni shqiptar për shpronësimet i garanton PP-ve të drejtën për ta çuar çështjen në

gjykatë për të kërkuar një shumë më të madhe kompensimi nga ajo e përcaktuar në vendimin për shpronësimet, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, por PP-të nuk mund ta sfidojnë procesin e shpronësimit. Pretendimet nuk sjellin pezullimin e procesit të shpronësimeve, megjithëse mund të sjellin kompensim më të lartë për t'u paguar nëse vendoset kështu nga gjykata kompetente. Ligji u ndryshua në mars të vitit 2020. Ndryshimi specifikon qartë se Personat e Prekur nga Projekti do të kompensohen sipas marrëveshjes ndërkombëtare të ratifikuar me ligj.

15. Aktualisht, investimet në zonat rurale po kryhen kryesisht nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit sipas udhëzimeve MS të KFW-së. Kalimi në zgjerimin rural të furnizimit me ujë do të jetë një aktivitet i ri për AKUM-in, dhe aktualisht ky i fundit nuk ka staf ose procedura për MS-në për të monitoruar këto lloje aktivitete. Për rrjedhojë, risku i përgjithshëm social lidhur me Programin është vlerësuar i konsiderueshëm.

16. **Rekomandimet dhe masat zbutëse për adresimin e risqeve kryesore të mundshme të identifikuara mjedisore dhe sociale.** Për sa i përket largimit dhe shkatërrimit përfundimtar të tubave prej asbesti, një rekomandim kyç është hartimi i një protokollit nga NU-të për të mbuluar zbulimin, largimin dhe shkatërrimin e tubave prej asbesti, dhe duhet të zhvillohen trajnime nga subjekte të kualifikuara në këtë fushë. Për projektet e dorëzuara për financim në kuadër të FR 2 dhe FR 3 nga grantet e performancës, NU-të duhet të tregojnë nëse ka materiale asbesti, dhe nëse po të paraqesin një plan për largimin e asbestit pranë AKUM-it për vlerësim.

17. **Lidhur me punimet e rehabilitimit në kuadër të FR 2 dhe FR 3,** megjithëse VNM-ja sipas standardeve dhe legjisllacionit kombëtar ka një listë parametrash për t'u monitoruar, ajo kërkon përditësimin e dokumentacionit, si dhe analizë të thelluar të të dhënave bazë. Proceset e menaxhimit dhe përcaktimi për përfshirjen e PMMS-ve duhet të bëhen pjesë e procesit të vlerësimit mjedisor dhe social. Kuadri ekzistues ligjor, duke përfshirë inspektoratin e punës dhe mjedisit të autoritetit shqiptar, ofron bazat dhe bashkërendimin me politikat operacionale të Bankës Botërore për punën dhe kushtet e punës, parandalimin e ndotjes dhe menaxhimit e riskut të biodiversitetit. Elementet lidhur me menaxhimin e risqeve për shëndetin dhe sigurinë e komunitetit duhet të integrohen në PMMS dhe VNM. Elementet duhet të përcaktohen dhe dokumentohen në planin e menaxhimit social të projektit. Për sa i përket ruajtjes së dhe menaxhimit të qëndrueshëm biodiversitetit, megjithëse ndikimet e shkaktuara nga projekti në biodiversitet mund të konsiderohen të papërfillshme, për çdo PMMS/VNM duhet të përgatitet një studim i bazë i përshtatshëm, në të cilin të tregohet çdo zonë e mbrojtur në afërsi, prania e habitatit të ndjeshëm, dhe ekosistemi i biodiversitetit tokësor, etj. Ky studim do të mundësojë ndikimet dhe do të identifikojë masat përkatëse zbutëse. Lidhur me trashëgiminë kulturore, miratimet dhe lejet ekzistuese nga autoritetet shqiptare ofrojnë bazat e sigurimit.

18. Duhet të forcohet edhe zbutja e ndikimeve mjedisore në elementet infrastrukturorë të projekteve të ujësjellësit. Duhet të identifikohen ndikimet e mundshme negative lidhur me projektimin, vendndodhjen, ndërtimin dhe operimin e infrastrukturës së përmirësuar. Duhet të ndërmerren masa zbutëse për t'i reduktuar ndikimet negative në nivele të pranueshme.

19. Duhet të adresohen masat zbutëse për reduktimin e riskut të ndikimeve të mundshme mjedisore dhe sociale gjatë ndërtimit dhe operimit. Elementet kryesore të ekspozuara ndaj riskut janë ajri, zhurma, peizazhi, dheu, mbetjet e ngurta, uji dhe biodiversiteti.

- a. Përfshirja e laboratorit të ujit dhe strukturës së dezinfektimit për të shmangur riskun në shëndetin publik për shkak të futjes së ujit të pasigurt të sistemin shpërndarës;
- b. Planet e menaxhimit për shmangien e grumbullimit të ujërave të ndotura shtëpiake në gropat septike në shtëpi mbi burimet ujore;
- c. Shkarkimi i ujërave të ndotura shtëpiake në kanalet aty pranë për të parandaluar ndotjen mikrobiologjike të burimit;
- d. Forcimi i kërkesave mjedisore dhe sociale, veçanërisht për blerjen e tokës dhe verifikimin e pronarit të tokës, identifikimin e zonave të mbrojtura të mjedisore ose të ndjeshme;
- e. Ulja e sasisë së ujit pa të ardhura për të ofruar zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve ujore. Menaxhimi i përmirësuar i burimeve ujore për të shmangur mbipërdorimin dhe kullimin, duke marrë në konsideratë edhe ndikimet negative të ndryshimeve klimatike në reduktimin e prurjeve;
- f. Masat e kompensimit për pemët që do të priten në tubacionet shpërndarëse;
- g. Për punimet ndërtimore në pyje duhet të bihet dakord me Administratën Pyjore dhe Autoritetin e Ruajtjes së Natyrës. Pozicionimi i burimeve të zhurmës në një zonë të izoluar lidhur me receptorët akustikë, në përputhje me nevojat e kantierit të ndërtimit;
- h. Për parandalimin e kontaminimit të dheut nga derdhjet, rrjedhjet ose shkarkimet e naftës/grasos, të gjitha manipulimet me derivatet e naftës në procesin e ndërtimit dhe sigurimit të lëndës djegëse për makineritë duhet të kryhen me kujdesin maksimal;
- i. Të gjitha llojet e mbetjeve të gjeneruara gjatë fazës së ndërtimit duhet të ndahen sipas burimeve të mbetjeve duke zbatuar parmet e hierarkisë së masave zbutëse;
- j. Ofrimi i trajnimeve të duhura për çështje mjedisore, të shëndetit dhe sigurisë (MShS) për të gjithë punëtorët e ndërtimit, duke përfshirë prezantimin fillestar dhe trajnimin periodik për rifreskimin e njohurive;
- k. Zbatimi i masave të sigurisë publike në fusha kritike të punimeve, si barriera sigurie dhe shenja paralajmëruese.

20. Për ndikimet e mundshme të identifikuara janë sugjeruar masat e duhura për shmangien/zbutjen/përmirësimin. Masat e duhura të monitorimit për të garantuar operimin dhe menaxhimin afatgjatë dhe të qëndrueshëm të furnizimit me ujë paraqiten në planin e monitorimit.

21. Gjatë fazës së ndërtimit, pritet të shkaktohen ndikime të mundshme nga krijimi i pluhurit për shkak të gërmimit të dheut dhe rimbushjes; Kontaminimi i dheut nga derdhjet aksidentale dhe shqetësimet për banorët, trafiku për shkak të punimeve ndërtimore; Zhurma nga motorët e makinerive të ndërtimit dhe pajisjeve të tjera; Rreziqet/aksidentet lidhur me shëndetin dhe sigurinë gjatë dhe pas ndërtimit, shqetësimet/dëmtimi/degradimi në zonat e njohura dhe të pazbuluara, të cilat mund të jenë të rëndësishme për shkak të mungesës së njohurive bazë.

22. Këto janë ndikime të mundshme të lidhura me proceset ndërtimore, dhe ka metoda të mirëzhvilluara për zbutjen e tyre. Sugjerohen masa të ndryshme, duke përfshirë:

- a. Masat për reduktimin/kontrollin e krijimit të pluhurit (mbulimi/spërkatja me ujë; konsolidimi i shtresës së sipërme të dheut, mbulimi gjatë transportimit, etj.);
- b. Ofrimi i informimit publik paraprak dhe planifikimi i punës në konsultim;
- c. Pozicionimi dhe/ose projektimi i kujdesshëm i impiantit siguron barriera për zhurmat, p.sh., argjinatura për dherat;
- d. Përdorimi i pajisjeve dhe metodave të përshtatshme të ndërtimit;
- e. Caktimi i kontraktorëve me përvojë. Përfshirja e kërkesave mjedisore dhe të sigurisë në dokumentet e kontratës;
- f. Kryerja e procedurës së gjetjeve rastësore, që konsiston në një plan veprimi të harmonizuar me rregulloren/legjislacionin shqiptar dhe praktikat e mira ndërkombëtare, i cili përshkruan procedurat hap pas hapi dhe subjektet përgjegjëse;
- g. Maksimizimi/prioritizimi i mundësive për punësim për banorët vendas;
- h. Marrja në konsideratë e sigurimit të një “qendre informacioni” për informimin e publikut mbi progresin e zhvillimit.

23. Për ta ndihmuar AKUM-in në ngritjen e kapaciteteve, stafi i MS-së duhet të jetë pjesë e përbërjes së ekipit të shqyrtimit të projektpropozimeve. Trajnimi për këto kapacitete duhet të ofrohet përpara shqyrtimit të investimeve që do të konsideroheshin të pranueshme për disbursim në kuadër të Programit PpR.

24. AKUM-i duhet të zhvillojë Procedurën Standarde të Operimit (PSO) për MS-në për të gjitha investimet që i nënshtrohen shqyrtimit, dhe kriterëve të pranimit e treguesve për të monitoruar performancën gjatë zbatimit. Vetëm investimet që janë shqyrtuar sipas këtij procesi duhet të jenë të pranueshme për mbështetje në kuadër të këtij Programi PpR.

25. Si pjesë e dokumentacionit të propozimit të investimit për punime në kuadër të Fushave të Rezultateve 2 dhe 3:

- Shqyrtimi do të përfshijë dokumente kadastrale zyrtare, inspektim fizik dhe dëgjuesë publike sipas rastit, kryesisht për zgjerimet. Publiku do të informohet për shtrimin dhe vendosjen e tubacionit.
- Ndërmarrjet/bashkitë duhet të tregojnë nëse investimet do të ndikojnë në përdorimin e pasurive/tokës të jopronarëve, duhet të ofrojnë kompensim dhe të dokumentojnë kompensimin e ofruar për pasuritë e prekura.
- Ndërmarrjet/bashkitë duhet të tregojnë nëse investimet do të kërkojnë blerjen e përkohshme të tokës. Nëse po, në propozim duhet të përfshihet edhe marrëveshja me shkrim me pronarin e tokës.

26. Plan i Veprimit i Propozuar për Programin

Përshkrimi i veprimit	Burimi	LTD#	Përgjegjësia	Afati kohor	Matja e përfundimit
Specialistë të Kualifikuar	VSSM		MIE AKUM	Sipas efikasitetit	AKUM-i ka staf përgjegjës për MS-në

Mjedisorë dhe Socialë (MS) të punësuar në ekipin e shqyrtimit të projektpropozimit të AKUM-it dhe një buxhet i përshtatshëm për të forcuar koordinimin e menaxhimit mjedisor dhe social.					në njësinë e shqyrtimit dhe njësinë e monitorimit të investimeve me buxhet të alokuar për funksionet e reja.
PSO për MS-në për të gjitha investimet që i nënshtrohen shqyrtimit, dhe kriterëve të pranimi e treguesve për të monitoruar performancën gjatë zbatimit	VSSM		AKUM	Sipas efikasitetit	PSO e miratuar për MS-në. Treguesit raportohen çdo 6 muaj.

Seksioni I. Përshkrimi i Programit

27. Programi i Shpenzimeve kap vlerën e përgjithshme prej 135 milionë dollarësh amerikanë për aktivitete specifike, shpenzime dhe rezultate të identifikuar në kuadër të Fushave të propozuara të Rezultateve që mbështesin arritjen e objektivave strategjike të SKS-së, të përzgjedhura nga programi i përgjithshëm i shpenzimeve qeveritare për sektorin. PpR-ja për Programin Kombëtar të Modernizimit do të bashkëfinancohet nga Banka (75 milionë dollarë amerikanë) dhe QSh-ja (60 milionë dollarë amerikanë)

Fusha e Rezultateve 1 – Kuadër Kombëtar i Forcuar

28. Kjo FR përfshin aktivitete, shpenzime dhe rezultate që mbulojnë politika për investimet publike në sektor, instrumente rregullatore, sistemi informacioni dhe skema të ngritjes së kapaciteteve në nivel qendror (ku adoptimi dhe zbatimi i tyre në nivel vendor mbulohet nga FR Nr. 2)². Fusha e Rezultateve 1 mbulon edhe forcimin institucional të tre institucioneve kryesore në nivel qendror (MIE, AKUM dhe ERRU). Rezultatet kyçe janë përshtatur për përmirësimin e kuadrit të përgjithshëm të qeverisjes së sektorit për drejtim, monitorim dhe mbikëqyrje të përmirësuar të ofrimit të shërbimit të UK-së nga ana e institucioneve qendrore, dhe për performancë dhe përputhshmëri të përmirësuar nga niveli vendor (bashkitë dhe ndërmarrjet e UK-së). Rezultatet përfshijnë vendime dhe instrumente për politika kyçe, si: lidhjen e investimeve publike dhe alokimit të subvencioneve operacionale për performancën dhe harmonizimin me veprimet e prioritizuara (si performancë e përmirësuar operacionale dhe financiare nga ndërmarrjet e UK-së); dhënien e incentivave për të ndikuar në vendime specifike (pra, rajonalizimi); udhëzime për financimin e investimeve për akses të ri në ujësjellës; projektimin përfundimtar dhe operimin e një platforme/sistemi krahasimi dhe informimi për shërbimet kombëtare të UK-së dhe performancën e ndërmarrjeve³; ose zhvillimin e mëtejshëm të Programit Kombëtar të Certifikimit për profesionistët e sektorit të ujit, me një kërkesë të planifikuar për ndërmarrjet e UK-së për të punësuar vetëm staf të certifikuar për pozicionet kyçe. Programi Kombëtar i Certifikimit mbështetet në përpjekjet për të siguruar ofertën për ngritjen e kapaciteteve në vend nëpërmjet nismave të ndryshme, duke përfshirë bashkëpunimin e vazhdueshëm me programe rajonale të donatorëve (Programi i Danubit për Ujin dhe RrRZhK (Rrjeti Rajonal i Zhvillimit të Kapaciteteve). Qeverisja më e mirë e sektorit të UK-së dhe financimi i bazuar në incentiva do t'ua bëjë më të thjeshtë ndërmarrjeve të UK-së që të ndërmarrin hapat e nevojshme për të përmirësuar efikasitetin operacional dhe qëndrueshmërinë e tyre financiare, duke e bërë në këtë mënyrë sektorin më rimëkëmbës ndaj thatësirave dhe përmbytjeve të lidhura me ndryshimet klimatike, të parashikuara për të ardhmen. Rezultatet e pritshme mund të grupohen në dy fusha të gjera që pasqyrohen si gurë kyç kilometrikë për TLD Nr. 1:

- i. **Instrumente dhe incentiva të përmirësuara të financimit të sektorit për performancë të përmirësuar të adoptuar:** me gurë kyç kilometrikë që shërbejnë si

² Kjo Fushë Rezultatesh mbështetet në rekomandimin e Politikës së Financimit të Sektorit të Ujit për Njerëzit 2016, të miratuar nga Qeveria (përgatitur nga një grup punë i drejtuar nga Këshilli Kombëtar i Ujit, duke përfshirë përfaqësues të nivelit të lartë nga Ministria e Financave dhe Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, që janë njëkohësisht përgjegjës për shërbimet e UK-së në vend, me mbështetje nga Banka Botërore dhe konsulentë nga COWI dhe VALU Ad gjatë 2015-2016)

³ AKUM-i është gati të prezantojë një sistem të ri të menaxhimit të të dhënave dhe komunikimit online, të zhvilluar nga shoqëria shqiptare Horizon, e cila do të përfshijë një modul të monitorimit/krahasimit të TKP-ve për ndërmarrjet e UK-së. Mund të jetë i nevojshëm ofrimi i trajnimit për Ndërmarrjet e UK-së për raportimin e duhur në këtë modul.

miratim i udhëzimeve të reja të politikave me kritere të pranueshmërisë dhe metodologji të bazuar në performancë⁴ për alokimin e subvencioneve të buxhetit të shtetit për: i) ndikimet e COVID19 dhe shpenzimet operationale; ii) investimet kapitale; iii) rajonalizimin/ristrukturimin e NU-ve; iv) aksesin e ri në ujësjellës në zonat pa shërbim.

Fusha e Rezultateve 2 – Performancë e Përmirësuar Operationale dhe Financiare e Ndërmarrjeve të UK-së (50 milionë dollarë amerikanë)

29. Kjo FR do të shpërblejë kompensimi e masave, proceseve dhe sistemeve që përmirësojnë performancën e ndërmarrjeve bashkiake të ujësjellësit, duke përfshirë instrumente moderne të punës, sisteme tregtare, matje në shtëpi ose në blloqe banimi, reduktimin e ujit pa të ardhura, eficiencën e energjisë, rritjen e orëve të shërbimit dhe cilësisë së shërbimeve, përmirësimin e qeverisjes dhe ngritjen e kapaciteteve të fuqisë punëtore, dhe rritjen e ndërgjegjësimit dhe angazhimit të komunitetit në sektor, duke përfshirë përdorimin e optimizuar të planit ekzistues të mbështetjes sociale për familjet e varfra dhe/ose të cënueshme. Pothuajse të gjitha këto masa, por në veçanti reduktimi i UPA-së, përdorimi i matësve, zbatimi i instrumenteve moderne të punës, dhe menaxhimi më i mirë financiar dhe operacional (duke përfshirë mirëmbajtje më të mirë të infrastrukturës së ujësjellësit) do të rrisin vëllimin dhe cilësinë e ujit të disponueshëm. Kjo e fundit do të forcojë rimëkëmbjen e sektorit të ujësjellësit ndaj pamjaftueshmërisë së ujit në të ardhmen, të shkaktuar nga ndryshimet klimatike, si dhe mundësinë e trajtimit të vëllimeve të mëdha të ujërave të ndotura, ndërsa operationet dhe mirëmbajtja më e mirë e infrastrukturës së ujërave të ndotura do të reduktojnë kontaminimin e trupave ujqorë, dhe rrjedhimisht ndikimin e mundshëm të një përmytjeje. Zgjedhja e rezultateve për t'u mbështetur/shpërblyer do të lidhet me nënobjektivat operationale, të mbulimit dhe financiare të vendosura në Kontratat e Performancës së qeverive vendore dhe ndërmarrjeve të UK-së me MIE/AKUM-in, të cilat do të monitorohen dhe rishikohen çdo vit. Kjo FR do të mbështesë tre lloje aktivitësh nëpërmjet përputhshmërisë me kërkesat dhe arritjes së rezultateve specifike në nivel vendor.

a) **Mbështetja për COVID19 dhe Grantet e Bazuara në Performancë (GBP):** Për vitin 2020, grantet do të mbulojnë subvencionet për shpenzimet operative për t'iu shpërndarë ndërmarrjeve të UK-së, si pjesë e përgjigjes ndaj emergjencave për situatën e COVID19, të alokuara sipas udhëzimit ministror përkatës të vitit 2020, i cili përcakton rregullat për aksesin në mbështetjen financiare. Mbështetja në të ardhmen ndaj ndërmarrjeve për shpenzimet operative do të drejtohet nga një udhëzim i ri për t'u adoptuar në Fushën e Rezultateve Nr. 1, dhe do të kushtëzohet për ndërmarrjet që përmbushin kërkesa të caktuara lidhur me rregullimet për qeverisjen e korporatës dhe ato që arrijnë nënobjektivat e përcaktuara në marrëveshjet e tyre të performancës.

B) **Projektet e Përmirësimit të Eficiencës dhe Performancës,** duke përfshirë asistencën teknike dhe shpenzimet kapitale që mundësojnë përmirësimin e eficiencës operationale dhe realizueshmërisë financiare/rikuperimit të kostove, si dhe përmirësimin në nivel shërbimi. Kjo përfshin: **Infrastrukturën e Furnizimit me Ujë 24/7, përcaktimin e ZMQ-ve (Zona Matëse të Qarkut), reduktimin e UPA-së, matjen dhe përmirësimin e tjera** në zonat urbane dhe rurale me dendësi të lartë të popullsisë ose në fokusin strategjik të QSh-së për Turizmin, të përfshirë në programin e QSh-së "100 Fshatrat"; ii)

⁴ Bazuar në vlerësimet vjetore të performancës së Ndërmarrjeve të UK-së të kryera nga AKUM-i

Investimet në eficiencën e energjisë në ndërmarrjet me konsumin më të lartë të energjisë janë identifikuar si prioritet për investimet e Programit. Aktualisht, janë identifikuar ndërhyrje specifike për eficiencën e energjisë në Durrës, Vlorë, Elbasan dhe Belsh (shihni shtojcën 2 bashkëlidhur)⁵ dhe nëpërmjet komponentit FPI do të zhvillohen audite të mëtejshme të detajuara të energjisë për të identifikuar masat e mëtejshme në këto dhe të tjera ndërmarrje; iii) **Masat e tjera rimëkëmbëse të ndërmarrjes në planet e biznesit/planet e përmirësimit të performancës së ndërmarrjeve** që do të përgatiten në zbatim të udhëzimeve për t'u hartuar nga AKUM-i, në koordinim me ERRU. Kriteret dhe metodologjia për alokimin do të zhvillohet në kuadër të Fushës së Rezultateve Nr. 1.

c) **Paketa e incentivave për proceset e rajonalizimit të ndërmarrjeve**, e zhvilluar nga ndërmarrjet/bashkitë nëpërmjet ngritjes së njësive rajonale. Kjo FR do të shpërblejë zbatimin e vullnetshëm të proceseve të agregimit të ndërmarrjeve, bazuar në studimet ekzistuese mbi këtë temë në Shqipëri dhe në AT-në e fundit nga SShÇE-ja për këtë çështje. Agregimi i ndërmarrjeve pritet të incentivohet nëpërmjet paketave financiare të ofruara nga qeveritë vendore dhe ndërmarrjet e UK-së, për t'iu mundësuar mbështetësve të dalin vullnetarë dhe të angazhohen në bërjen e të gjitha përpjekjeve për një proces të suksesshëm. Studimet e fizibilitetit do të financohen nga komponenti i FPI-së. Incentivat financiare do të financohen nga PpR-ja, ndërsa përmirësimet e pritshme të shërbimit në këto bashki (në cilësi, akses dhe eficiencë) do të shpërblehen në kuadër të Fushës së Rezultateve 2. Siç u theksua edhe më herët, procesi i agregimit të ndërmarrjeve do të përfshijë ekonomitë e shkallës dhe krijimin e ndërmarrjeve rajonale më të qëndrueshme të dalluara nga nivelet e larta të performancës dhe rikuperimit të kostos. Nga ana tjetër, këto do të nxisin qëndrueshmërinë e përgjithshme financiare dhe eficiencën operationale të sektorit, duke i mundësuar në këtë mënyrë mbulimin e shërbimit dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të veta. Shërbimet e zgjeruara cilësore do të ulin ndikimin e mundshëm në të ardhmen të thatësirave dhe përmbytjeve të shkaktuara nga ndryshimet klimatike.

Rezultatet e pritshme specifike në këtë fushë rezultatesh janë:

- i. *Alokimi vjetor i granteve dhe shpenzimeve kapitale të buxhetit të shtetit bazuar në vlerësimin vjetor të performancës*, me gurë kyç kilometrikë që janë: i) Udhëzime përfundimtare dhe alokimi i GBP-ve për ndërmarrjet/bashkitë e pranueshme; ii) Identifikimi dhe alokimi shumëvjeçar i buxhetit të shtetit për Projektet e pranueshme të Eficiencës dhe Performancës në Planin Buxhetor Afatmesëm, pas procesit APA;
- ii. Përmirësimi në pikët kombëtare të mbledhura për performancën e përgjithshme dhe mbulimin direkt të kostove (nga baza).

⁵ Bazuar në vlerësimin paraprak në katër zonat (që zënë 40% të ngarkesës së lidhur dhe konsumit vjetor), u identifikuan kursimet paraprake prej rreth 3.6 milionë dollarësh amerikanë në vit (brenda këtyre 4 ndërmarrjeve), me një periudhë të kthimit të investimeve prej më pak se 6 vjetësh.

- iii. *Prezantimi i Proceseve të Rajonalizimit të Ndërmarrjeve:* Me gurë kyç kilometrikë që janë alokimi i paketës së incentivave dhe pagesës për qeveritë vendore përkatëse pas marrëveshjeve zyrtare nga qeveritë/ndërmarrjet vendore kundrejt ndërmarrjeve të UK-së që përmbushin kërkesat nga qeveria qendrore për të mbështetur proceset e rajonalizimit sipas udhëzimeve të politikave për t'u zhvilluar në kuadër të Fushave të Rezultateve Nr. 1.

Fusha e Rezultateve 3 (FR3): Mbyllja e hendekut drejt aksesit universal në shërbimet e ujësjellësit (20 milionë dollarë amerikanë).

30. Kjo FR do të mbështesë ndërtimin, rehabilitimin dhe operimin e lidhjeve në ujësjellës në zona pa shërbim (duke përfshirë zonat rurale). Pritet që Programi të ofrojë financim për rreth 10,000-12,000 lidhje të reja familjare (nga të cilat përfitojnë rreth 40,000-50,000 persona), që do të nënkuptonte mbylljen e hendekut ekzistues të mbulimit me rreth 3%. Rezultatet e pritshme kyçe janë 12,500 lidhje të reja familjare në ujësjellës funksional të sigurt dhe të besueshëm në zonat e synuara, gjatë periudhës së zbatimit të programit; dhe iv) udhëzimet e reja të nxjerra nga AKUM-i lidhur me strukturat e kanalizimeve në terren, në përputhje me Direktivën e BE-së për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane (DTUNU).

Seksioni II. Përshkrimi i Efekteve të Pritshme Mjedisore dhe Sociale të Programit

Efektet e mundshme MS

Përfitimet MS

31. **Fusha e Rezultateve 1, Fusha e Rezultateve 2, Fusha e Rezultateve 3:** Programi ka mundësinë të zgjerojë aksesin në furnizimin me ujë për zonat urbane dhe rurale me shërbim të pamjaftueshëm. Do të instalohen matës të rinj për të matur me saktësi konsumin e ujit dhe për të frenuar humbjen e ujit. Përfitimet sociale mund të përfshijnë ofrim më të shënjestruar të shërbimit për popullatat me shërbim të pamjaftueshëm, shërbim cilësor, pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve në zhvillimin e nismave në sektorin e ujit. Nëpërmjet rregullimit dhe prerjes së lidhjeve të paligjshme në ujësjellës mund të nxitet ruajtja e ujit, pasi përdoruesit kanë më pak gjasa ta shpërdorojnë ujin për të cilin ata tarifohen. Përfitimet ekonomike do të rrisin vlerën e shtuar të fluksit të mjeteve monetare në ekonominë kombëtare dhe vendore për kohëzgjatjen e investimit përmes rritjes së prodhimit bujqësor, përmirësimit të shërbimeve për komunitetet dhe qytetarët, krijimit të vendeve të reja të punës, etj. Zhvillimi i raportimit të centralizuar do t'i ofrojë MIE-s dhe AKUM-it mundësinë për alokim më efikas dhe të përgjigjshëm të burimeve, bazuar në të dhënat nga mbarë vendi.

Ndikimet negative MS

32. Ndikimet e mundshme negative mjedisore kanë gjasa të ndodhin gjatë fazës së ndërtimit dhe zbatimit, sipas fushës së rezultateve 2. Këto përfshijnë punimet ndërtimore që ndikojnë në dhe, në ujërat nëntokësore dhe ujërat sipërfaqësore në kantierin e kontraktorit. Ndikimi mund të

lindë edhe si rrjedhojë e gjurmimeve dhe gjenerimit të dheut të tepërt, erozionit për shkak të gjurmimit/rimbushjes, ndikimet për shkak të ndërtimeve në burim, ndikimet në cilësinë e ajrit në mjedis për shkak të gjenerimit të pluhurit dhe ndikimet në cilësinë e ajrit për shkak të emetimeve nga mjetet. Largimi i bimësisë/pemëve për ndërtim dhe ndikimet për shkak të pranisë së kanaleve të hapura. Kontaminimi i mjedisit rrethues dhe ndikimet në SShP (siguria dhe shëndeti në punë) nga asbesti në infrastrukturën e vjetër të tubacionit, të prodhuar prej tubash asbesti gjatë mirëmbajtjes së lidhjeve në ujësjellës janë po ashtu ndikime negative të projektit.

33. Ndikimet e mundshme negative sociale për fushat e rezultateve 2 dhe 3 përfshijnë blerjen e përkohshme dhe të përhershme të tokës gjatë zgjerimit të lidhjeve në ujësjellës dhe ndërtimit të objekteve të reja të ujësjellësit. Mund të ketë shqetësime të përkohshme për lagjet si rrjedhojë e aktiviteteve të mirëmbajtjes së tubacionit të ujësjellësit, zbulimit ose riparimit të rrjedhjeve, dhe pastrimit dhe inspektimit të tubacionit, sipas rastit. Zakonisht, riparimet kryhen kryesisht në të njëjtën mënyrë me shtrimin e tubave. Do të gjermohen kanale për zbulimin e zonës së rrjedhjes dhe do të rimontohet lidhja difektoze, ose nëse është e nevojshme tubi do të hiqet dhe zëvendësohet.

34. Përpara ndërtimit duhet të merren parasysh ndikimet e risistemimit për shkak të rinovimit të stacioneve të pompimit (zëvendësimi i nënstacioneve të pompave të vjetra me të reja me energji më efikase) në rezervuarët e vjetër, dhe shtrimi i tubacionit të ujësjellësit përmes pronave private. Gjenerimi i pluhurit, zhurmave, dhe ndotja e ajrit dhe ujit nga aktivitetet e ndërtimit, si dhe ndërprerja e shërbimeve të furnizimit me ujë për periudha të gjata kohore që mund të ndikojnë në aktivitetet rezidenciale dhe të biznesit, dhe në burimet socio-kulturale. Shqetësimet, bezdisjet dhe zhurmat për shkak të aktivitetit të ndërtimit, duke përfshirë transportimin e materialeve dhe mbetjeve.

35. Po ashtu, edhe aktivitetet e ndërtimit mund të sjellin zbulimin e burimeve historike dhe arkeologjike.

36. Gjatë operimit, ndikimet e mundshme negative mund të përfshijnë kontaminimin e burimeve ujore dhe riskun e ofrimit të ujit të pasigurt për konsumatorët.

37. Tarifat e furnizimit me ujë mund të rriten për disa si rrjedhojë e metodologjisë së rishikuar të planifikuar nga rregullatori, edhe pse diçka e tillë nuk do të jetë pjesë e programit. Prerja e lidhjeve të paligjshme në ujësjellës do të ndikojë në aksesin në ujë të familjeve dhe bizneseve që kanë lidhje të paligjshme. Për këto lidhje të paligjshme do të ofrohet mundësia e blerjes së matësve dhe e pasjes së një shërbimi cilësor. Familjet më të varfra, të cilat kanë pasur akses falas në ujë nëpërmjet mekanizmave të “vetëshërbimit”, do të humbasin aksesin si rrjedhojë e Programit. Kjo mund të zbutet përmes zbatimit të një instrumenti të mbrojtjes sociale që ofron një subvencion për familjet e cenueshme⁶. Nëpërmjet FPI-së do të zhvillohen aktivitete të AT-së për të forcuar mbulimin dhe komunikimin për programin referencë, që subvencionon koston e furnizimit me ujë dhe të matësve për familjet e cenueshme.

⁶Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 18, datë 12.01.2018. Vendimi iu lejon ndërmarrjeve të ujësjellësit të rimbursohen nga qeveria qendrore për koston e lidhjes dhe instalimit të matësit për familjet që i përkasin kësaj kategorie të të cenueshme.

Faktorët Kontekstualë të Riskut

38. Një risk fillestar që u mor në konsideratë nga objekti i VSMS-së ishte nëse investimet në ujësjellës do të lënë pas dore investimet në trajtimin e ujërave të ndotura (ITUN), duke sjellë përkeqësimin e problematikave me cilësinë e ujit. Në bazë të udhëzimeve të KFW-së që ndiqen për punimet ITUN të planifikuara në Shqipëri për vitet e ardhshme, ITUN-i i ri do të projektohet për zbatim në fazë, duke marrë në konsideratë horizontin e mëposhtëm të propozuar të projektimit dhe kapacitetet e trajtimit, për aq kohë sa ekziston një fakt se mbulimi 100 për qind nuk është arritur ende. Inxhinierët përgjegjës për projektimin e detajuar të investimeve ITUN përlogaritën popullatën e zonës, dhe prurjet e mundshme që do të gjenerohen në rast arritjes së mbulimit 100 për qind në zonë. Prandaj, sipas këndvështrimit të ekipeve të vlerësimit risku i këtij ndikimi të mundshëm është i ulët.

Tabela 1: : Udhëzimet e KFW-së për Horizontin e Projektimit dhe Kapacitetet e ITUN-it

Faza	Viti	Kapaciteti i projektimit	Vërejtje
Faza 1	2020	Lidhjet dhe përlogaritjet aktuale	3-4 vjet për projektimin, përfundimin dhe kolaudimin
Faza 2	2040	Mbulim 100 për qind	Përfundimi i zgjerimit dhe rehabilitimit të ofruar të rrjetit të kanalizimeve

(burimi: Krijimi i ITUN-it, Programi i Infrastrukturës Bashkiake III – Shqipëri 2016)

39. Ekziston mundësia për një rritje të ankesave drejtuar BB-së, duke pasur parasysh besimin në institucion të opinionit publik shqiptar, lidhur me punimet e financuara në kuadër të Programit. Si shembull dhe bazuar në përvojën nëpërmjet një operacioni FPI të mbyllur së fundmi në Durrës me të njëjtën agjenci të zbatimit të projektit (AKUM), ka pasur ankesa lidhur me rehabilitimin e rrugëve pas instalimit të tubacionit të ujësjellësit. Ankesat u raportuan edhe në faqen e Facebook-ut të BB-së, ashtu si edhe zgjidhja e këtyre çështjeve. Megjithëse ankesa u trajtua në mënyrë të kënaqshme nga NjZP-ja e AKUM-it, NjZP-së iu desh të kryente punime të kujdesshme shtesë me komunitetin për të menaxhuar pritshmëritë e komunitetit, pasi kërkesa e tyre ishte që NjZP-ja të rregullonte të gjithë seksioni e rrugës dhe jo vetëm seksionin lidhur me punimet për shtrimin e tubacionit të ujësjellësit.

40. Ndjeshmëritë për Agregimin e Ndërmarrjeve të Ujësjellësit. Plani afatgjatë është reduktimi i numrit të ndërmarrjeve nga 58 ndërmarrje që mbulojnë 61 bashkitë në një numër më të vogël ndërmarrjesh më të qëndrueshme dhe të shëndetshme në aspektin financiar. Disa ndërmarrje kanë treguar interes për ruajtjen e kompetencave ndërsa disa të tjera e pranojnë e nuk i kanë kapacitetet e nevojshme, ose nuk ka kuptim në aspektin ekonomik që të operojnë si ndërmarrje të veçanta.

41. Shumë prej rrjeteve të ujësjellësit janë ndërtuar në vitet 1960. AKUM-i nuk ka të dhëna zyrtare lidhur me vjetërsinë e tubacioneve dhe ndërmarrjet që mund ta kenë këtë informacion. Megjithëse disa zona raportojnë për mbulim të konsiderueshëm, sistemet e vjetruara dhe

joefikase sjellin risqe mjedisore dhe sociale, si ofrimi i mundshëm i ujit që nuk përmbush standardet e cilësisë.

Risqet e Kompleksitetit dhe Kapaciteteve Institucionale

42. Fushëveprimi kombëtar i Programit sjell risqe të kompleksitetit institucional, duke pasur parasysh se Programi është i hapur në 61 bashki dhe 58 ndërmarrje. Megjithëse legjislacioni që drejton bashkitë dhe ndërmarrjet e ujësjellësit është kombëtar në fushëveprimin e tij, zbatimi i legjislacionit dhe procedurave të MS-së mund të ndryshojë.

43. Ekziston një risk që gjatë procesit të agregimit të ndërmarrjeve të mos përcaktohen qartë rolet dhe përgjegjësitë për stafin e ndërmarrjeve, çka mund të sjellë ndërprerjen e shërbimit nëse nuk përcaktohen qartë procedurat e marrjes në dorëzim. Gjatë mbledhjeve për fushëveprimin e Programit PpR, AKUM-i pranoi se disa ndërmarrje nuk i kanë kapacitetet për menaxhimin e ITUN-ve. Gjithashtu, ka edhe shqetësime se shtimi i lidhjeve në ujësjellës do të shqërohet me rritjen e konsumit të ujit, dhe do të gjenerojë më shumë shkarkime të ujërave të ndotura, çka mund të sjellë lënien pas dore të kapaciteteve ITUN që tashmë mungojnë.

44. Ka disa partnerë për zhvillim që ofrojnë asistencë teknike dhe financim për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri, duke përfshirë Agjencinë Austriake për Zhvillim (ADA), BE-në, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ), Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW), Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SShÇE), Agjencinë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Kombëtar (SIDA), dhe Agjencinë e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Megjithëse partnerët për zhvillim kanë tendencën të ndajnë informacion për aktivitetet që mbështesin, AKUM-i DHE MIE luajnë një rol koordinues në menaxhimin e burimeve, duke siguruar se koordinimi për qasjen e forcimit të aspekteve të ndryshme është çelësi për bashkërendimin e përpjekjeve për ngritjen e kapaciteteve. Fondi Shqiptar i Zhvillimit punon në tonat rurale dhe nuk ka një ndarje të qartë për sa i përket kompetencave ndërmjet fondit dhe AKUM-it. Bashkëpunimi Financiar Gjerman, nëpërmjet KfW-së, po ofron financim lidhur me projekte për investime dhe ngritje kapacitetesh në zonat urbane, të cilat mbulojnë ujësjellës-kanalizimet në kuadër të Programit të ri të Infrastrukturës Bashkiake (PIB V). PIB V përqendrohet në investimet e prioritizuara të Master Planit së sektorit të ujësjellësit në rreth dhjetë ndërmarrje të ujësjellësit në Shqipëri. Këto përfshijnë: Berat, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Kamëz, Kuçovë, Lezhë, Lushnjë, Sarandë, Shkodër dhe Vlorë. Për projektet e financuara nga KfW-ja, njësitë e zbatimit duhet të ndjekin udhëzimet e KfW-së dhe janë që të gjitha të mirorientuara drejt çështjeve të MS-së. Për të siguruar zbatimin e të gjitha masave zbutëse të sugjeruara, përgatitet një program për monitorimin mjedisor. Duke pasur parasysh zbatimin e plotë të masave zbutëse dhe përmirësuese, nuk duhet të ketë ndikime negative mjedisore të konsiderueshme për shkak të nënprojektit. Në fakt, me vendosjen në punë të skemës duhet të ketë përfitime pozitive përmes përmirësimeve madhore në cilësinë e jetës dhe shëndetit të individëve dhe publikut.

Risqet Politike dhe të Reputacionit

45. Për sa u përket risqeve politike dhe të reputacionit, ekzistojnë risqe për agregimin lidhur me interesat e atribuara ndërmarrjeve të vogla që mund të përthithen nga ndërmarrjet më të mëdha. Këto risqe mund të zbuten përmes zhvillimit të metodologjisë për agregim, e cila është metodologji me pjesëmarrje dhe gjithëpërfshirëse, si dhe përmes zbatimit të një strategjie

komunikimi për procesin e agregimit, e cila do të mbështetet nga komponenti AT i FPI-së. Ekziston një perceptim publik se procesi për të vendosur se kush paguan për zëvendësimin e matësve të dëmtuar nuk është plotësisht transparent. Ky aspekt mund të zbutet edhe nëpërmjet qartësimin më të madh të procedurave dhe komunikimit të përmirësuar me përfituesit për ligjin e ri për ujin (aktualisht është version paraprak), i cili adreson disa nga këto shqetësime. Një tjetër risk lidhet me përvojën e mëparshme në vend për blerjen e tokës. Duke pasur parasysh se instrumenti PpR funksionon përmes sistemeve në vend për programin, ka një shqetësim lidhur me mundësinë për të monitoruar dhe siguruar që çdo proces që zhvillohet për blerjen e përkohshme të tokës të kryhet në përputhje me Politikën dhe Direktivën e PpR-së, për shkak se vendndodhja e aktiviteteve dhe numri i njerëzve që mund të ndikohen është aktualisht i panjohur. Rekomandimet për adresimin e këtyre risqeve detajohen në seksionet pasuese të raportit të VSMS-së.

Seksioni III. Vlerësimi i Sistemeve të Menaxhimit Mjedisor dhe Social të Huamarrësit lidhur me Programin

46. Sistemi për menaxhimin e MS-së të Programit PpR përcaktohet nga ligjet, procedurat dhe subjektet përkatëse të përshkruara në vijim. Kuadri ligjor kombëtar shqiptar është mjaft harmonizuar me legjislacionin e BE-së. Kuadri ligjor shqiptar lidhur me çështjet mjedisore dhe socio-ekonomike bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe përfshin ligje dhe akte rregullatore, si Vendime të Këshillit të Ministrave (VKM), akte ministrore, rregullore, udhëzime dhe standarde. Këshilli Kombëtar i Ujit dhe Sekretariati i tij Teknik, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (grupi nëntematik për ujin për njerëzit), Ministria e Mjedisit / Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Ministria e Shëndetësisë / Instituti i Shëndetit Publik (monitorimi i cilësisë së ujit), si dhe Enti Rregullator i Ujit janë palët kryesore të interesit që angazhohen në shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve në nivel qendror. Palët kyçe të interesit në nivel vendor janë bashkitë, ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve dhe shoqëria civile.

Sistemi i Menaxhimit Mjedisor

47. Krahas legjislacionit që lidhet posaçërisht me nevojën për një Vlerësim të Ndikimit Mjedisor (VNM), ekzistojnë edhe politika, ligje dhe rregullore kombëtare të zbatueshme për Programin e propozuar PpR dhe aspektet e tij mjedisore dhe sociale. Për më tepër, Shqipëria ka zhvilluar standarde mjedisore që bazohen kryesisht në Direktivat e Komisionit Evropian. Standardet ekzistuese përfshijnë mbrojtjen e biodiversitetit; trashëgiminë kulturore; emetimet në ajër; cilësinë dhe shkarkimet e ujit, si dhe menaxhimin e mbetjeve.

48. Ligji Nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM)” shpjegon kategorinë e projekteve që duhet t’i nënshtrohen procedurës së VSM-së dhe se si mund të ndiqet procedura hap pas hapi. Procedura e VSM-së është një kërkesë ligjore për planet dhe programet në nivel kombëtar për sektorë të ndryshëm, ose kur projekti apo ndikimet e projektit ndërthuren me kufirin e një vendi tjetër.

49. Ligji Nr. 10440, datë 07/07/2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, ndryshuar me Ligjin Nr. 12 / 2015, përcakton përgjegjësinë e autoriteteve përkatëse për procesin e VNM-së dhe bën një klasifikim të përgjithshëm të projektit që i nënshtrohet kërkesave të tipit A ose B. Projektet që i nënshtrohen VNM-së renditen në Shtojcat e ligjit për VNM-në (Shtojca I dhe Shtojca II). Në zbatim të ligjit, Zhvilluesi që ka planifikuar të zhvillojë një projekt të ri, gjatë fazave të para të studimit të fizibilitetit, duhet t’i referohet klasifikimit të ligjit, si dhe të drejtojë një kërkesë zyrtare pranë AKM-së për klasifikimin e llojit të projektit. Rastet e vlerësuara me risk të ulët konsiderohen si të kategorisë A dhe për to kërkohet vetëm një VNM paraprake. Për kategorinë B kërkohet një procedurë e thelluar e VNM-së.

50. Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 686 (29.07.2015) “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis”. Ky akt përcakton rregulla specifike dhe të detajuara për procedurën, kuadrin e raportit të VNM-së dhe shtojcat, afatin e procedurës, aplikimin për miratim, vendimin përfundimtar dhe monitorimin e raportimin e ndikimit gjatë ekzekutimit të projektit. Raporti i VNM-së duhet të përgatitet në përputhje me këtë VKM.

51. Në zbatim të Ligjit Nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” dhe VKM-së Nr. 416, datë 13/05/2012, “Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore”, çdo pus ekzistues që është aktualisht në përdorim nga ndërmarrja e ujësjellësit duhet të pajiset me leje shfrytëzimi, dhe pusët e reja të planifikuara për t’u hapur duhet t’i nënshtrohen procedurës së shpjeguar në kuadrin ligjor të lartpërmendur për të marrë lejen për hapjen dhe shfrytëzimin e pusit. Pas miratimit zyrtar për përdorimin e ujit, ndërmarrjet e ujësjellësit duhet të respektojnë marrëveshjen e shpjeguar në VKM, e cila përfshin edhe instalimin e matësve të mëdhenj të ujit për monitorimin e sasisë së ujit të përdorur.

52. VKM-ja Nr. 247 (30.04.2014) “Për përcaktimin e rregullave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”. Palët e interesit duhet të angazhohen/konsultohen nëpërmjet procesit të VNM-së; duhet të zhvillohet dhe zbatohet Plani i Angazhimit të Palëve të Interesit (PAPI). Në bazë informacionit të marrë nga kryetari i ERRU-së, në procese të ndryshme dhe procedurat e vendimmarrjes që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë te konsumatori, si rritjet e tarifave, protokollit i njoftimit hap thirrjet për pjesëmarrje të grupeve të interesit, dhe procedura është e zbatueshme dhe transparente. Procedura e dëgjësive publike është e mirëdokumentuar, dhe përmban të gjitha shqetësimet dhe sugjerimet e PP-ve, por në fund, feedback-u jo domosdoshmërisht merret në konsideratë në vendimin përfundimtar. Procesi i dëgjësive konsiderohet më shumë si një procedurë e informimi dhe transparence për publikun sesa si përfshirje e publikut në vendimmarrje. Gjithashtu, VKM-ja Nr. 379, datë 25.05.2016, për miratimin e rregullores “Cilësia e ujit të pijshëm”, konkretisht neni 26 “Informimi i konsumatorit” kërkon transparencën dhe publikimin e rezultateve të monitoruara. Njoftimi i publikut është një kërkesë ligjore në rastet kur uji i pijshëm rezulton i kontaminuar, në bazë të monitorimit të rregullt të kryer nga autoriteti kompetent i Institutit të Shëndetit Publik. Procedura është një protokoll i brendshëm që duhet të respektohet nga ndërmarrjet e ujësjellësit dhe drejtoria përkatëse rajonale e shëndetit publik.

53. Ligji Nr. 162 (04.12.2014, që ka hyrë në fuqi nga janari i vitit 2018) “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, është përafshuar plotësisht me Direktivën 2008/50/KE “Për cilësinë e ajrit në mjedis dhe një ajër më të pastër në Evropë”, si dhe Direktivën 2004/107/KE lidhur me arsenikun, kadmiumin, merkurin, nikelin dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajrin e ambientit. Ky ligj hyri në fuqi më 1 janar 2018 dhe siguron kuadrin institucional, rregulloret, rolet dhe penaltitetet për të garantuar përputhshmërinë. Ligji përcakton që personat fizikë dhe juridikë, qofshin publikë apo privatë, vendas apo të huaj, të jenë përgjegjës për ruajtjen e ajrit të pastër dhe mbrojtjen e tij nga ndotja e shkaktuar nga aktivitetet që ata zhvillojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

54. VKM-ja Nr. 177, datë 31.03.2005, “Për normat e shkarkimeve të ujërave të ndotura” parashikon mbrojtjen e burimeve ujore. Të gjitha shkarkimet e lëngëta duhet të jenë në përputhje me standardet dhe rregulloret shqiptare për cilësinë, temperaturën dhe erën përpara shkarkimit në mjedis. Duhet theksuar se nuk ka asnjë normë për strukturat e vogla të shkarkimeve të ujërave të ndotura, dhe normat aktuale marrin në konsideratë vetëm normat e shkarkimeve në komunitetit pas trajtimit në një impiant të posaçëm. Aktualisht, nuk ka norma specifike për shkarkimet aglomerateve të vogla (siç mund të jenë kampet me më pak se 200 punëtorë). Në mungesë të këtyre normave të emetimit për projektin, mund të zbatohet një normë ose rregullore ndërkombëtare, por për këtë duhet të bihet dakord me autoritetet,

nëpërmjet një procedure qartësimi për instalimet e (mundshme) kampeve në terren dhe menaxhimin e tyre.

55. Ligji Nr. 10237, datë 18/02/2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM-ja Nr. 312, datë 05/05/2010 për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” janë baza e kuadrit ligjor që shpjegon dhe tregon udhëzimin kryesor për çështjet e shëndetit dhe sigurisë gjatë ndërtimit të projekteve të infrastrukturës së ujit.

56. VKM-ja Nr. 379, datë 25.05.2016, për miratimin e rregullores “Cilësia e ujit të pijshëm” është baza e legjislacionit kombëtar që iu kërkon NU-ve të përmbushin kriteret e paraqitura në shtojcat e VKM-së. “Rregullorja e ujit të pijshëm.” Objektivi i saj është mbrojtja e shëndetit të njerëzve nga efektet negative të kontaminimit të ujit për konsum nga njerëzit, duke siguruar se ai është me shumicë dhe i pastër. Ajo rregullon disa çështje lidhur me testimin e ujit të pijshëm dhe zonat mbrojtëse përreth puseve të ujit ose depozitave të ujërave nëntokësore në komunitet. Rregullorja përcakton tre zona mbrojtëse (zona tampon) nga pusët e ujërave nëntokësore ose vendet e depozitave të ujit në tokë. Zona e menjëhershme e mbrojtjes varion nga 15 në 100 metra nga boshti i pusit ose depozitës. Distanca e saktë përcaktohet bazuar në vlerësimin e formacioneve gjeologjike nëpërmjet një eksperti të hidrogeologjisë. Zona e dytë dhe e tretë tampon rrethon zonën e parë, dhe për këto zona rregullorja nuk përcakton asnjë kriter distance, por kufizon aktivitetet që mund të ndikojnë në cilësinë e ujit, si grumbullimi ose djegia e mbetjeve, punime në minierë, etj.

Institucionet

64. **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)**. Kjo është agjencia qeveritare përgjegjëse për politikën kombëtare ndaj ndryshimeve klimatike dhe bashkëpunimin ndërkombëtar për ndryshimet klimatike, çështjet e energjisë, metrologjinë dhe studimet gjeologjike kombëtare, energjinë elektrike, ujin, shërbimet e ujërave të ndotura dhe industrinë në Shqipëri. MIE ka nën varësi Drejtorinë e SKS-së që është përgjegjëse për formësimin e metodologjisë së agregimit të ndërmarrjeve të ujësjellësit, metodologjinë e vendosjes së tarifave dhe studime të tjera që ndikojnë në sektorin e ujit. Gjithashtu, ato i delegojnë AKUM-it buxhetin për programe investimesh që kryhen nga ndërmarrjet e ujësjellësit.

65. **AKUM**. Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM) është organi i vetëm shtetëror i specializuar në fushën e furnizimit me ujë të pijshëm, kanalizimeve dhe ujërave të ndotura, dhe trajtimit të tyre (infrastruktura e ujit). Ajo mbështet teknikisht politikën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në përputhje me legjislacionin dhe politikën e qeverisë të përcaktuara në strategjitë sektoriale. Nëpërmjet autoritetit të vet ligjor dhe teknik, AKUM-i është përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e furnizimit me ujë, trajtimit të ujërave të zeza dhe aktiviteteve të trajtimit për të gjithë popullsinë e vendit, në bashkëpunim me qeveritë vendore dhe organet e menaxhimit të infrastrukturës së ujit. Për të përmbushur misionin e saj në mbështetje të kuadrit të përgjithshëm të aktivitetit të Ministrisë, AKUM-i vlerëson aspektet teknike për projektet infrastrukturore të propozuara për financim, dhe vendos se si do të alokohen fondet. AKUM-i ofron financim përmes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, kostove vendore, doganave dhe rimbursimit të TVSH-së, kontratave të miratuara të financuara nga donatorë të ndryshëm. AKUM-i monitoron marrëveshjet e performancës së ndërmarrjeve dhe bashkive. Po ashtu, AKUM-i monitoron performancën e NU-ve nëpërmjet krahasimit. Zhvillimi i procedurës kërkohet çdo 3 muaj, dhe ndërmarrjet e ujësjellësit duhet të paraqesin standardet e tyre të performancës së krahasuar. ERRU-së i lejohet të monitorojë

performancën e NU-ve lidhur me tarifat, bazuar në raportet e tyre dhe në formatin krahasues. Format i është i ndryshëm nga AKUM-i dhe zbatohet çdo 6 muaj. Procedura e shqyrtimit të projektit është përgjegjësi e Drejtorit të Kontrollit Teknik dhe e Drejtorit të Investimeve dhe Planifikimit, që të dy pjesë e AKUM-it: Kërkesat kryesore për procedurën e shqyrtimit janë miratuar me Vendim të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 18, datë 31/12/2008. Ky dokument u përditësua me më shumë kërkesa për dokumentet, në bazë të përvojave dhe mësimet të tjera të nxjerra, dhe u prezantua në VKM-në e fundit përkatëse Nr. 354, datë 26.05.2016.

66. **Bashkitë.** Bashkitë luajnë një rol të rëndësishëm në procedurën e blerjes së tokës në rastet kur trualli/parcela e planifikuar për një ndërtim (rezervuar, impiant, stacion pompimi, ITUN, etj.) është në pronësi të një personi apo subjekti privat, dhe rrjedhimisht shpronësimi është i nevojshëm. Njëpërmjet bashkisë, Agjencia Publike e Ndërmarrjeve aplikon për shpronësimin e tokës pranë MIE-s. Ky institucion siguron financim për kompensimin e pronarit. Çmimi i truallit përcaktohet nga regjistrimi më i fundit i çmimeve, i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë. Edhe procedura e shpronësimit miratohet nga Këshilli i Ministrave. Gjithashtu, në raste të caktuara (projekte rehabilitimi), bashkitë japin leje ndërtimi për ndërmarrjet e UK-së.

67. **KKT.** Institucioni i autorizuar përgjegjës për lëshimin e lejes së ndërtimit është KKT-ja (Këshilli Kombëtar i Territorit), e drejtuar nga Kryeministri ose zëvendësi i tij. KKT-ja jep leje ndërtimi për infrastrukturën e re, ku për projekte rehabilitimi, si projektet e ujësjellës-kanalizimeve, lejet e ndërtimit do të merren nga bashkia.

68. Ligji Nr. 8752/2001 "Për ngritjen dhe funksionimin e strukturave të administrimit dhe mbrojtjes së tokës", ndryshuar me Ligjin Nr. 10257/2010 që rregullon çështjet e përdorimit të tokës dhe përputhshmërinë e tyre me Planifikimin Rajonal. Drejtoria e administrimit të tokës e çdo bashkie është përgjegjëse për menaxhimin e tokës dhe dhënien me qira të tokës shtetërore. Ky autoritet do të jetë përgjegjës për koordinimin e procedurave të zbatimit dhe kryerjen e pagesave gjatë zbatimit të projektit. Bashkitë kryejnë prokurimin për NU-të që kanë mungesë kapacitetesh. Kur zhvillon procedurën e prokurimit, bashkia është përgjegjëse për përcaktimin e kriterëve që mund të sigurojnë dhe garantojnë që kontraktori i parapërzgjedhur të ketë kapacitetet për të përmbushur standardet dhe kërkesat, duke përfshirë menaxhimin mjedisor, shëndetin dhe sigurinë.

69. **Ndërmarrjet e Ujësjellës-Kanalizimeve.** Krahas ofrimit të shërbimit, ato kanë autoritetin ligjor për të vënë gjoba dhe për të ndërprerë furnizimin me ujë nëse përballen me rastet e përmendura si në vijim:

(1) Ndërhyrje në rrjetin e ujësjellësit konsiderohen rastet kur përdoruesi i ujit të pijshëm bën një shtesë në rrjetin e ujësjellësit që sjell harxhimin e ujit pa marrë më parë leje nga NU-ja.

(2) Ndalohet çdo lloj manovrimi në rrjetin e ujësjellësit nga persona që nuk janë autorizuar nga NU-ja. Kundërvajtësit gjobiten sipas ligjeve në fuqi. Referuar Ligjit Nr. 7697, datë 07.04.1993 "Për kundërvajtjet administrative", me ndryshime, si dhe VKM-së Nr. 96, datë 22.02.2007, "Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jofamiljarë", me ndryshime, pika 5.

(3) Ndalohet ndërhyrja në rrjetin e ujësjellësit, si dhe lidhjet e pamiratuara nga NU-të.

(4) Ndalohet ndërhyrja në matësit e ujit dhe dëmtimi i vulës së matësit.

(5) Ndalohet kategorikisht ndërtimi i objekteve mbi tubacionet e ujësjellësit.

(6) Ndalohet kategorikisht përdorimi i ujit të pijshëm për larje, ujitjen e tokave bujqësore, lagjen e shtrimeve dhe rrugëve, nevoja teknologjike të paparashikuara më parë në projekte, dhe të pamiratuara më parë nga NU-të.

Gjithashtu, NU-të kanë kompetencën ligjore për të bërë ndërprerjen e furnizimit:

- Furnizimi ndërpritet në raste shumë të veçanta për të parandaluar çdo rrezik të menjëhershëm në sigurinë e njerëzve ose në rrjetin e ujësjellësit, si dhe për të shmangur çrregullimet në furnizimin me ujë të konsumatorëve të tjerë, ose prishjen e cilësisë së ujit të pijshëm. NU-ja ka të drejtën të ndërpresë furnizimin me ujë në rastet e mëposhtme:

(a) Në rast të mosshlyerjes së detyrimeve financiare brenda afatit kohor ligjor siç përcaktohet në kontratën e furnizimit me ujë;

(b) Nëse konsumatori ndërhyr në mënyrë të paligjshme në sistemin e ujësjellësit ose manipulon matësin e ujit;

(c) Në rast se konsumatori bën lidhje të paautorizuara në një shoqëri anonime të ujësjellës-kanalizimeve ose shkakton dëme të çfarëdolloji në sistemin e ujësjellësit;

(d) Në rast të kushteve të pazakonta, si thatësira, etj., kur konsumatori është i detyruar të mos e tejkalojë konsumin mbi normën që NU-ja e bën publike në media;

(e) Konsumatori përfitues i asistencës sociale furnizohet nga NU-ja me 20l/person në ditë, pa pagesë, dhe shoqëria do të instalojë matësin me qëllim pagimin për konsumin e ujit mbi këtë normë. Lista e konsumatorëve të favorizuar do të merret zyrtarisht nga bashkia/komuna e zonës ku shoqëria ofron shërbimin.

- Kundërvajtjet dhe kundërvajtjet penale

(1) Ndërhyrjet në sistemin e ujësjellësit, lidhjet e pamiratuara nga NU-ja, dëmtimet e çfarëdolloji në sistemin e ujësjellësit përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë deri në 10,000 Lek (rreth 95 Euro) për klientët familjarë, dhe deri në 50,000 Lek (rreth 450 Euro) për konsumatorët jofamiljarë, si dhe me ndërprerje të furnizimit me ujë. Kundërvajtësit janë të detyruar të paguajnë shpenzimet e nevojshme për kthimin në gjendjen e mëparshme të pjesës së dëmtuar. Si referencë shërben VKM-ja Nr. 96, datë 22.02.2007, "Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jofamiljarë", me ndryshime, neni 5. Vendimi mbi dënimin mund të ankimohet te Drejtori i NU-së brenda 15 ditësh nga marrja e njoftimi. Vendimi i Drejtorit është përfundimtar. Vendimi i tij mund të ankimohet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor.

(2) Referuar Nenit 159 të Kodit Penal, "Shkatërrimi i rrjetit të ujësjellësit", "Shkatërrimi ose dëmtimi me dashje i rrjetit të ujësjellësit dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet. Lidhja, si dhe çdo ndërhyrje tjetër e bërë pa leje në rrjetin e ujësjellësit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

70. Shoqëritë e kontaktuara: Pas përmbylljes me sukses të procedurës së prokurimit, dhe pasi kontraktori fitues të ketë filluar zbatimin e projektit, NU-ja lirohet nga çdo përgjegjësi ligjore për atë kohë sa shoqëria mbikëqyrëse që do të kontaktohet përmes prokurimit ka detyrën për të mbikëqyruar dhe siguruar që kontraktorët të operojnë në përputhje me rregulloret për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe ligjet për mjedisin. Por, për shkak të faktit se NU-ja do të jetë përfituesja e investimit, ndonjëherë gjatë ndërtimit ata ushtrojnë kontroll të dyfishtë për aktivitetet e kontraktorit, për të siguruar që gjithçka të kontrollohet dhe monitorohet si duhet.

71. **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)**. MTM-ja është përgjegjëse për ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve natyrore në Shqipëri, duke përfshirë mbrojtjen e mjedisit, burimet pyjore, biodiversitetin, kullotat dhe rrjedhat ujore. Biodiversiteti në Shqipëri mbrohet nga legjislacioni i posaçëm dhe mjetet praktike si ngritja e një sistemi të Zonave të Mbrojtura (ZM). Aktualisht, qeveria qendrore po ristrukturon dhe decentralizon sistemin e administrimit dhe menaxhimit të ruajtjes së natyrës, të përqendruar kryesisht në burimet pyjore dhe kullotat. Synimi është forcimi i kuadrit ekzistues rregullator dhe të politikave; krijimi i një administrate më efikase të ZM-ve; mundësimi i pjesëmarrjes dhe përfshirjes aktive të qeverive vendore në menaxhimin e ZM-ve, Zonave Pyjore dhe tokave kullotë; lehtësimi i trajnimit të duhur të stafit të administratës; dhe ofrimi i mbështetjes financiare dhe asistencës teknike për menaxhimin e ZM-ve dhe ruajtjen e biodiversitetit. Gjithashtu, MTM-ja, në bashkëpunim me departamentin e inxhinierisë së mjedisit në Universitetin Politeknik të Tiranës, bëjnë një thirrje të hapur një herë në vit për procedurën e certifikimit të Specialistëve për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor. MTM-ja është përgjegjëse për klasifikimin e aplikantëve bazuar në përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në VKM-në Nr. 268, datë 24/04/2003, “Për certifikimin e specialistëve për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor”, dhe më pas aplikantët që e kalojnë procesin e parë të shqyrtimit nga MTM-ja i nënshtrohen një procedure testimi që administrohet dhe drejtohet nga stafi akademik i Departamentit të Inxhinierisë së Mjedisit. Aplikantët që kalojnë testin do të pajisen me certifikatën për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Auditimin Mjedisor. Në vitin 2017, kjo procedurë u ndërpre dhe MTM-ja po punon për përmirësimin e sistemit të certifikimit.

72. **Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural** luan një rol të rëndësishëm në menaxhimin e burimeve ujore dhe drejton organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore. Misioni i Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore është qeverisja e mirë e burimeve ujore për të përmbushur të gjitha nevojat jetike, duke mbajtur parasysh qëndrueshmërinë e ekosistemeve, duke nxitur konkurrueshmërinë e përdorimeve dhe avantazhet drejt përfitueshmërisë ekonomike. Agjencia ka disa përgjegjësi dhe detyra për menaxhimin e sektorit të ujit. Ajo: Planifikon, ekzekuton, kontrollon punën dhe siguron që produktet ose shërbimet të ofrohen në kohë, brenda buxhetit, dhe në sasinë e cilësinë e kërkuar.

- Integron kërkesat për ofrimin e produktit optimal, në përputhje me standardet ndërkombëtare, në mënyrë konsistente dhe të sigurt.
- Analizon progresin, vlerëson devijimet nga objektivat, standardet dhe plani i menaxhimit, dhe menaxhon ndryshimet e nevojshme në program dhe burime.
- Harton dhe monitoron zbatimin e të gjitha planeve të menaxhimit të kërkuara nga ligji, nëpërmjet zyrave të menaxhimit të baseneve lumore, në bashkëpunim me

strukturat shtetërore përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi, si me palët e tjera të interesit.

- Menaxhon dhe koordinon procesin e programimit, zbatimit dhe monitorimit të nismave/projekteve/programeve të menaxhimit të burimeve ujore në bashkëpunim me ministritë e linjës, institucionet qendrore dhe vendore, donatorët dhe partnerët e tjerë për zhvillim.
- Kryen menaxhimin e përgjithshëm sipas ligjit të organeve të menaxhimit të burimeve ujore, njësisive të qeverisjes vendore, organeve dhe strukturave përgjegjëse të ministrive, institucioneve shtetërore dhe aktorëve përkatës lidhur me marrjen e masave dhe zbatimin e legjislacionit për sektorin e ujit.

73. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM). AKM-ja u krijua si një ristrukturim i Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve në mbështetje të Ligjit Nr. 10431, datë 09.06.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit" dhe VKM-së Nr. 47, datë 29.01.2014 "Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të Agjencive Rajonale të Mjedisit ". AKM-ja është një institucion publik qendror nën varësinë e Ministrisë së Linjës, i cili ushtron juridiksionin e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Agjencia Kombëtare e Mjedisit financohet nga buxheti i shtetit dhe nga burimet e veta, dhe gëzon pavarësi në vendimmarrje dhe kryerjen e funksioneve të saj të parashikuara me ligj. AKM-ja është njësi përgjegjëse që shqyrton dhe miraton të gjitha aplikimet mjedisore lidhur VNM-në dhe procedurën e lejes mjedisore.

74. Palët kyçe të interesit në nivel vendor janë bashkitë, ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve, banorët, bizneset, si dhe shoqëria civile. Së fundmi, NU-të janë decentralizuar dhe kanë kaluar në pronësi të bashkive, por nuk janë ende në gjendje të mbulojnë kostot e tyre operative. Në shumicën e rasteve, mungesa e kapaciteteve në nivel ndërmarrjeje, e pronësisë në nivel vendor dhe e mbështetjes së duhur në nivel kombëtar ka sjellë mospajtimin e një shkalle normale të operimit dhe performancës së instalimeve të ndërtuara. Palët e interesit më të prekura janë qytetarët (familjet) për shkak të mbulimit të dobët me shërbim (ujësjellës-kanalizime) që iu ofrohen atyre.

Sistemi i Menaxhimit Social

Ligji Nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik" rregullon të drejtën e shtetit për të shpronësuar ose për të marrë në përdorim të përkohshëm për interes publik pasuritë e personave fizikë ose juridikë privatë, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të pronarëve përkatës. Kërkesat për shpronësim paraqiten në ministrinë përgjegjëse që mbulon veprimtarinë përkatëse, ndërsa propozimi në Këshillin e Ministrave për miratimin e kërkesës për shpronësim, bëhet nga ministri përkatës. Me paraqitjen e kërkesës për shpronësim për interes publik, ministri kompetent urdhëron ngritjen e komisionit të posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit. Anëtarët e komisioneve duhet të jenë nëpunës ose ekspertë të pavarur, me përvojë dhe kualifikim të posaçëm në fushën juridike, ekonomike dhe inxhinierike, të cilët, në çdo rast, nuk duhet të kenë asnjë lloj lidhjeje me të shpronësuarit, ose interesash të çdo lloji me palët e interesuara për shpronësimin. Rregullat për përbërjen dhe procedurat e punës së komisionit të posaçëm për shpronësimet caktohen me akt normativ të Këshillit të Ministrave. Kompensimi ofrohet mbi bazën e një vlere monetare dhe çmimet janë publikuar në VKM-në Nr. 89, datë 03/02/2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë". Çmimet e prezantuara për njësi për shpronësimet janë përgjithësisht nën vlerën e tregut. Duke

qenë se çmimet i përkasin vitit 2016, ato nuk janë domosdoshmërisht të mjaftueshme për blerjen e pasurive zëvendësuese me vlerë të barasvlershme dhe për të paguar shpenzimet e nevojshme të përkohshme.

75. Ligji për njoftimin e konsumatorit për shërbimet e ujit, VKM-ja Nr. 379, datë 25.5.2016 për miratimin e rregullores “Cilësia e ujit të pijshëm”. Kjo rregullore përcakton kërkesat e cilësisë së ujit të pijshëm, me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik nga efektet negative të ndotjes së tij, duke siguruar që uji është i shëndetshëm dhe i pastër. Sipas nenit 26, informacioni i dhënë përdoruesve duhet të jetë i besueshëm, i përshtatshëm, i mjaftueshëm dhe i përditësuar në çdo aspekt të përshkruar në këtë rregullore, përmes çdo mjeti të mundshëm komunikimi nga secili autoritet kompetent i përfshirë dhe nga administratorët.

76. Në kontratat e shërbimit të ujësjellësit parashikohen përgjegjësitë ndërmjet ndërmarrjeve dhe familjeve.

77. **ERRU**. Mandati i ERRU është të mbrojë interesat e konsumatorëve, dhe është anëtar i **Shoqatës Evropiane të Rregullatorëve të Ujit**. ERRU ka rishikuar politikën e konsultimit publik dhe ka hartuar procedurën që duhet të ndjekin ndërmarrjet e ujit për organizimin e dëgjësive publike. Për sa i përket mbulimit dhe konsultimit publik, këto procese përfshihen në disa aspekte të sistemit të huamarrësit. ERRU-ja iu kërkon ndërmarrjeve të ujësjellësit që të zhvillojnë dëgjësia publike për tarifën dhe dërgon vëzhgues në dëgjësia publike dhe mban procesverbale. ERRU-ja përgatit një raport të performancës, i cili publikohet në gjuhën shqipe dhe përfshin analizë sipas madhësisë së ndërmarrjes. Raportet vjetore përgatiten dhe dorëzohen çdo muaj janar për të raportuar në kuvend në një seancë plenare mbi progresin e shënuar nga ndërmarrjet e ujësjellësit. ERRU-ja ka edhe një sistem për pretendimet e konsumatorëve. Një person luan rolin e pikës fokale. Çdo pretendim dorëzohet pranë një komisioni që është Bordi i ERRU-së dhe drejtori i saj është kryetari i komisionit. Megjithatë pretendimet mund të depozitohen përmes email-it ose faqes së internetit, drejtori i ERRU-së ka vënë re se konsumatorët preferojnë që t'i dorëzojnë pretendimet fizikisht. Shumica e pretendimeve marrin zgjidhje dhe ERRU-ja luan rolin e ndërmjetësit. Afërsisht 30 për qind e tyre zgjidhen në favor të konsumatorëve. Nëse konsumatorët nuk bien dakord me rekomandimet, atëherë ata kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës për zgjidhje. Ankesat lidhen kryesisht me problematikat me matësit e ujit, leximet e pasakta, mbifaturimin, dhe ndryshimin e matësve nga ndërmarrjet pa një lajmërim paraprak.

78. **Sistemi i Përgjithshëm Kombëtar i Ankesave** Ekziston edhe një sistem kombëtar i menaxhimit të ankesave, i quajtur platforma e bashkëqeverisjes, e krijuar nga Kryeministria. Ky është një aplikacion online me shtrirje kombëtare. Qytetarët mund të depozitojnë ankesa lidhur me korrupsionin, shërbimet e dobëta ose ankesa të tjera lidhur me institucionet publike, duke përfshirë ndërmarrjet e ujësjellësit. Ankesat i dërgohen drejtorisë qendrore të administratës në kryeministri, dhe më pas i delegohen drejtorisë përkatëse përgjegjëse për ofrimin e shërbimit. Drejtoria përkatëse, pra marrësi, duhet t'i përgjigjet personit që ka depozituar pretendimin me një përgjigje ose argument profesional, maksimalisht brenda 10 ditësh, dhe administratori i sistemit kombëtar të ankesave ndjek përgjigjen. Norma e kthimit të përgjigjeve ndaj ankesave është 100%, falë monitorimit nga administratori i sistemit kombëtar të ankesave.

79. **Ndërmarrjet e Ujësjellësit kanë mekanizmat e veta të ankesave** që administrohen në mënyra të ndryshme. Për shembull, qytetarët në Elbasan mund të depozitojnë ankesa në të treja qendrat e shërbimit të klientit dhe paraqiten në pikat e mbledhjes ku bëhen pagesat e faturave. Ankesat mund të dërgohen edhe përmes email-it dhe Facebook-ut. Ankesat duhet të

adresohen brenda 10 ditësh nga marrja e tyre. Ndërmarrja e ujësjellësit përgatit raporte mujore që përfshijnë informacion për numrin e kërkesave të marra, të zgjidhura apo të atyre pezull. Shumë problematika lidhen me faturimet e ujit, dëmtimet në linjat e ujësjellësit dhe matësit e ujit. Që nga janari i vitit 2020, me mbështetjen e GIZ-it, në bashki po prezantohet një Portal kombëtar i Shërbimit të Klientit, <https://www.shuk.al/>, i cili përfshin një platformë të depozitimit të ankesave ku qytetarët mund të paraqesin ankesa lidhur me shërbimet, furnizimin me ujë ose rrjetin e kanalizimeve. Deri në mars të vitit 2020 parashikohej që 18 bashki shtesë t'i bashkoheshin platformës. Formulari i ankesave ofron edhe një adresë email-i, numër telefoni, dhe një link për faqen e Facebook-ut të ndërmarrjes së ujësjellësit. Shihni Shtojcën B për faqen model.

Rrjedha e Punës së Përpunimit të Projektit të Investimit

80. Propozimet e përpunimit të projektit bazohen në një hierarki kontrolli që nis nga niveli vendor dhe shkon deri në nivelin qendror: Bashkia/Ndërmarrja e Ujësjellësit → AKUM → Drejtori e kontrollit teknik (pjesë e AKUM) → Drejtoria e investimeve dhe planifikimit (pjesë e AKUM) → MIE → MFE → Bashkia/Ndërmarrjet e Ujësjellësit.

- a. Ndërmarrjet/Bashkia i paraqesin AKUM-it një kërkesë zyrtare për investim në infrastrukturën e ujësjellësit dhe kanalizimeve duke bashkëngjitur përlllogaritjet e detajuara të projektimit dhe kërkesat e formatit të listës së kontrollit.

Nr.	Dokumentacioni i Kërkuar
1	Detyrat e projektimit e hartuar nga një specialist i fushës mbajtës i licencës përkatëse dhe miratuar nga kreu i institucionit
2	Raporti teknik i hartuar dhe nënshkruar nga projektuesi që ka licencën përkatëse, së bashku me përlllogaritjet hidraulike dhe ndërtimore për operimin e rezervuarit të ujit, tubacionit, stacionit të pompimit
3	Hartimi i plotë i projektit dhe përlllogaritjet financiare të përgatitura nga specialistë të licencuar për kategoritë përkatëse të projektit të hartuar. Projekti duhet të shoqërohet me kopje të noterizuar të licencës së projektuesit
4	Planimetri të zonës ku ndodhet struktura, së bashku me linjat ekzistuese të furnizimit me ujë
5	Skema hidraulike ekzistuese e projektit
6	Hartë të gjeografisë fizike në shkallë 1:25000 në format A0
7	Planimetri të tubacioneve kryesore dhe të pikave të mbledhjes të rezervuarëve të ujit, etj.
8	Profile gjatësore në shkallë 1:2000 shoqëruar me të dhëna hidraulike
9	Linjat piezometrike të linjave të përgjithshme të furnizimit dhe dorëzimit
10	Skema hidraulike e ujësjellësit
11	Përditësimet e rrjeteve ekzistuese inxhinierike dhe kryqëzimet e mundshme me linja ekzistuese si ato elektrike, telefonike, fibra optike, etj.
12	Specifikimet teknike të hartuara nga projektuesi.
13	Projekti elektrik i hartuar nga një inxhinier elektrik i licencuar
14	Miratimi i pikës së lidhjes së energjisë elektrike nga institucioni përkatës
15	Përlllogaritja financiare duhet kryhet sipas VKM Nr. 2, datë 08.02.2003
16	Studimi hidrologjik i burimit ujqor apo shpimit të pusit
17	Analiza të plota kimike dhe bakterologjike të ujit
18	Studimi gjeologjik i gjurmës ku do të kalojnë tubacionet e ujësjellësit

- b. AKUM-i i dërgon propozimin drejtorisë së kontrollit teknik (pjesë e AKUM-it), që është përgjegjëse për kontrollin e dokumentacionit të aplikimit dhe për kontrollin e propozimeve bazuar në kërkesat e listës së kontrollit miratuar me Urdhër Nr.18 të Ministrit, datë 31.12.2008.
- c. Pasi aplikanti ka plotësuar të gjitha kriteret, drejtoria e kontrollit teknik nxjerr miratimin teknik. Në këtë fazë, projekti i miratuar teknik i dorëzohet për kontroll të mëtejshëm drejtorisë së Investimeve dhe Planifikimit (pjesë e AKUM-it). Bazuar në përparësitë dhe politikat dhe strategjitë kombëtare, dhe sipas planit të buxhetuar, të miratuar qeveria për këto lloj investimesh, kryhet një kontroll i dytë i projekteve teknike të miratuara. Vetëm projektet e parazgjedhura sipas miratimit në përputhje me strategjinë kombëtare për sektorin vijojnë më tej me procedurën e financimit në ministrinë e linjës dhe në MFE. Lista e projekteve dorëzuar ministrisë së linjës, MIE, janë projekte të miratuara tashmë nga AKUM.
- d. MIE i dërgon listën e miratuar të projekteve të miratuara shoqëruar me kostot e tyre të përgjithshme, që nuk tejkalojnë buxhetin e planifikuar për këtë sektor, MFE-së. Pas procedurës zyrtare të kalimit nga ministria e linjës tek MFE, merret miratimi për njësinë e zbatimit për të vijuar më tej me procedurën e tenderimit.
- e. Marrëveshjet nënshkruhen me kryetarin e bashkisë.
- f. Bashkia/Ndërmarrja e Ujësllësit zbaton prokurimin nga buxheti i miratuar. Kontraktorët duhet të plotësojnë standardet e kontratës dhe duhet të respektojnë të gjitha masat lehtësuese të përcaktuara në dokumentin e VNM-së.
- g. Bashkia harton një plan vjetor për të mbështetur përgatitjen e projekteve dhe kostot e mbikëqyrjes.
- h. Kostot e mbikëqyrjes përfshijnë procedurën e prokurimit kur një palë e tretë monitoron përputhshmërinë me produktet e kontratës, përfshirë aspektet mjedisore dhe sociale.

81. Për rastet që nuk kërkojnë marrjen e tokës, bazuar në kriteret e kontrollit, zhvilluesi duhet të interesohet në drejtorinë përkatëse të bashkisë dhe duhet të paraqesë një dokument zyrtar që deklaron se zbatimi i projektit nuk kërkon shpronësim të tokave. Në rastet kur ka një pronar të verifikuar ligjor dhe kur prona e tyre kryqëzohet me gjurmën e projektit, dhe kur nuk ka alternativë tjetër të mundshme, zhvilluesi duhet të paraqesë dokumentacionin ligjor të pronarit të tokës dhe duhet të përgatisë dosjen e shpronësimit sipas kërkesave të nenit 10 të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999 (ndryshuar me Ligjin Nr. 20/2016, datë 10.03.2016) “Për Shpronësimet dhe Marrjen e Përkohshme të Tokës Pronë Private për Interes Publik”. Vlera e plotë e shpronësimit bëhet pjesë e investimit të përgjithshëm që do të realizohet në kuadër të zbatimit të projektit. Për Programin PpR. Kontrolli identifikon gjithashtu edhe pronat e paligjshme dhe këta PP do të konsiderohen si të ligjshëm për qëllimet e kompensimit. Ata do të përfshihen në planin e marrjes së tokës/planit të veprimit të rivendosjes së bashku me pronarët e ligjshëm.

82. Progres Raporti i BE-së (2018) diskuton faktin që investimet e mëdha shpesh vonohen për shkak të procedurave të zgjatura të shpronësimit, që në shumicën e rasteve kërkojnë së pari regjistrimin e përshtatshëm të pronarëve të ligjshëm. Gjatë viteve të fundit investimet

publike shqiptare kanë zënë 4-5% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PPB), dhe ato janë penguar shpesh nga dobësitë në administrimin e investimeve publike. Gjithashtu, sa i përket të drejtave pronësore, raporti thekson se “duhet të bëhet ende progres lidhur me përmirësimin e kuadrit ligjor për regjistrimin, shpronësimin dhe kompensimin”. Programi PpR do të financojë punimet e rehabilitimit të ujësjellësve dhe zgjerimin e ujësjellësve, kështu që ka mundësi të jetë e nevojshme marrja e tokës për këto qëllime. Kjo është arsyeja përse nga pikëpamja sociale programi PpR kategorizohet si risk i konsiderueshëm. Procedurat kombëtare përshkruhen më poshtë.

- i. Zhvilluesi (Bashkia/NU) i dërgojnë dosjen e shpronësimit AKUM-it, që e ndjek procedurën dhe aplikon për shpronësimin e tokën në ministrinë e linjës MIE, e cila siguron fondet për kompensimin e pronarëve të prekur të tokës. Çmimi i ngastrave merret nga regjistri më i përditësuar i çmimeve të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë me ligj. Procedura e shpronësimit miratohet edhe nga Këshilli i Ministrave. Ligji Nr. 8752/2001, i ndryshuar disa herë, “Për Krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjes e tokës”, ndryshuar me Ligjin Nr. 10257/2010 që rregullon çështjet e përdorimit të tokës dhe përputhshmërinë e tyre me Planifikimin Rajonal. Drejtoria e administrimit të tokës në çdo bashki është përgjegjëse për administrimin e tokës dhe dhënien me qira të tokës në pronësi të shtetit. Ky autoritet do të jetë përgjegjës për bashkërendimin e procedurave të zbatimit dhe kryerjen e kompensimit gjatë zbatimit të projektit. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për çdo Rreth në zonën e Programit, nën varësinë e Zyrës Qendrore të Regjistrimit, që janë përgjegjëse për identifikimin dhe verifikimin e kufijve të pronave dhe pronësisë së tyre.

83. Shqyrtimi i kompensimit dhe pagesës së kompensimit ndërmerret nga gjykata, nëse PP-ja kundërshton vlerën e kompensimit, nëse nuk ka një mekanizëm përkatës ankesash për marrjen e tokës. Zakonisht vlerësimet kryhen nga një vlerësues i licencuar i pasurive të paluajtshme. Vlera e kompensimit bazohet në VKM Nr. 89 datë 3.2.2016.

84. Procesi i Shpronësimit

Hapi	Institucioni	Veprimi
1	Institucioni i interesuar, pra Bashkia/Ndërmarrja e Ujësjellësit paraqesin dosjen e shpronësimit në AKUM, që ndjek procedurën e kompensimit me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)	<ul style="list-style-type: none"> • Kërkesë për shpronësim për interes publik • Dosja e Shpronësimit
2	MIE	<ul style="list-style-type: none"> • Komisioni i shpronësimeve në MIE shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin • Nëse përmbushen kriteret ligjore, MIE nis

		procedurat e shpronësimit <ul style="list-style-type: none"> • Nëse jo, kërkesa refuzohet
3	MIE	<ul style="list-style-type: none"> • Marrëveshja me përfituesin e shpronësimit për shpronësimin • Shpallja e njoftimit për shpronësim • Shqyrtimi i sugjerimeve dhe ankesave të personave të prekur nga procesi • Përgatitja e projekt vendimit të Këshillit të Ministrave
4	Këshilli i Ministrave	<ul style="list-style-type: none"> • Miraton vendimin e shpronësimit për interes publik ose refuzon propozimin e MIE-s me sugjerimin për ta rishikuar, nëse nuk është në përputhje me ligjin
5	MIE	<ul style="list-style-type: none"> • I paguan kompensimin personave të prekur nga shpronësimi përpara fillimit të punimeve civile;

85. Procedura e Ankesave: PP-të e shpronësimit kanë të drejtën të ankohen në Komisionin e Shpronësimeve të MIE-s brenda 15 ditësh nga përfundimi i afatit të shpalljes publike. Gjithashtu, në fazën e Këshillit të Ministrave, pronarët e ndikuar kanë të drejtën të ankohen në Gjykatë brenda 30 ditësh nga botimi i Vendimit në fletoren zyrtare. Nëse ata nuk ndjekin këtë procedurë, Vendimi i Këshillit të Ministrave merr formën e titullit ekzekutiv. Neni 6 i ligjit për shpronësimet inkurajon marrëveshjet me negociata, duke përcaktuar se kur pronari bie dakord t'i transferojë pronën e vet shtetit sipas kushteve të ofruara nga ministria, shpronësimi konsiderohet i përfunduar. Pronari duhet të informojë ministrinë kompetente brenda 15 ditësh nga njoftimi lidhur me pranimin ose refuzimin e ofertës (neni 16). Nëse nuk arrihet marrëveshje, pasi vendimi për shpronësimin miratohet nga këshilli i ministrave, pronari i prekur ka të drejtën e ankimit në gjykatë lidhur me vlerën shpronësimit (neni 24). Sa i përket vlerës dhe afatit të shpronësimit, vlera e kompensimit duhet të bazohet në një vlerësim të pronave të prekura nga komisioni i shpronësimit, i cili konfirmohet nga vendimi i KM. Kjo dispozitë përcakton shprehimisht se zhvlerësimi i strukturave dhe asetëve duhet të merret në konsideratë. Nëse arrihet marrëveshje për kompensimin, transferimi i pronës dhe pagesa e kompensimit bëhen brenda 15 ditësh nga njoftimi i bërë nga pronari i prekur lidhur me pranimin e ofertës (neni 16). Nëse jo, kompensimi bëhet sipas vendimit për Shpronësimin miratuar nga këshilli i ministrave, brenda një periudhe prej tre muajsh, ose pas vendimit të gjykatës (neni 23). PP-të kontaktohen gjatë procesit të shpronësimit, por nuk ka konsultim publik.

Përmbledhje e Vlerësimit të Kapaciteteve të Institucioneve të Programit për të Zbatuar Sistemin e Menaxhimit të M&S të Programit

86. ERRU. ERRU ka personel të mjaftueshëm për të vëzhguar dëgjesat publike për tarifrat dhe për të administruar ngarkesën e tyre të punës lidhur me sistemin e ankesave dhe hartimin e raporteve. Megjithatë, ERRU është shprehur se do të vlerësonte ndihmën për përditësimin e Kodit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve dhe mbase për digjitalizimin e sistemit të tyre për regjistrimin e ankesave. Është rënë dakord që platforma e shërbimit të klientit do të jetë pjesë e

ERRU dhe do të zëvendësojë platformën aktuale të ankesave të klientëve, për sa kohë institucioni është njësi përgjegjëse për administrimin dhe mbledhjen e ankesave të klientëve për shërbimet e marra nga NU-të.

87. MIE. Sa i përket zbatimit të një procesi me pjesëmarrje në kuadrin e hartimit të politikave dhe ligjeve të reja, MIE ka përvojë të mëparshme pune me organe të tjera për mbështetje në arritjen e përputhshmërisë me legjislacionin në këtë kuadër. GIZ ka mbështetur MIE lidhur me Strategjinë që përcakton programin e qeverisë dhe GIZ ka financuar Vlerësimin Strategjik Mjedisor. Njoftimi për dëgjuesin publike u shpall në faqen zyrtare të MIE dhe MTM. Kryetarët e bashkive u ftuan me kërkesë zyrtare. Vlerësimi Strategjik Mjedisor u përfundua në janar 2020, dhe më pas raporti u vlerësua dhe miratua nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në shkurt 2020. Përvoja sugjeron që ata do të kishin mundësinë të zhvillonin dëgjuesin publike lidhur me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtare për procesin e Agregimit.

88. AKUM. Investimet në kuadër të fushës së rezultateve 2 kërkojnë që njësi zhvilluese (Bashkia/NU) t'ia kontraktojnë funksionet e MS-së konsulentëve të MS-së. AKUM nuk ka personel me përvojë në menaxhim mjedisor dhe social që mund të kryejë vlerësimin e propozimeve ose të ndjekë monitorimin e zbatimit. Sa i përket veprimtarive të zgjerimit të qasjes rurale, aktualisht AKUM nuk kryen investime në zona rurale dhe këto investime kanë qenë kryesisht nën kompetencën e FShZh-së. FShZh -ja ka personelin e vet të MS-së që monitoron investimet dhe ka pasur kryesisht mbështetjen e KFW dhe zbaton udhëzimet e KFW-së për MS-në.

89. AKUM është i aftë të raportojë për ankesat e marra dhe ka shpallur një regjistër me kërkesa dhe përgjigje në faqen e vet të internetit për vitet 2017, 2018 dhe 2019, që tregojnë numrin rendor të koordinatorit të ankesave, datën e regjistrimit të kërkesës, lëndën, datën e përgjigjes, si është kthyer përgjigja (email apo postë), gjendjen e kërkesës dhe nëse është zbatuar tarifë.

90. Ndërmarrjet e Ujësllësit Inxhinierët e ndërmarrjeve të ujësllësit nuk i njohin rregulloret e MS-së. Inxhinierët e ndërmarrjeve të ujësllësit nuk monitorojnë aspektet mjedisore dhe sociale të veprimtarive të ndërtimit. Ato rrallë kanë personel për MS-në dhe nuk ka protokolle apo procedura që përshkruajnë rolin dhe përgjegjësitë e inxhinierit të ndërmarrjes së ujësllësit lidhur me aspektet e monitorimit të MS-së.

91. Ndërmarrjet e Ujësllësit kanë kontrata me Institucionet e Shëndetit Publik. Në praktikë, ndonjëherë Institucionet e Shëndetit Publik nuk kanë kapacitete për të analizuar/monitoruar cilësinë e ujit në sistemin e furnizimit me ujë, veçanërisht në zonat rurale. Monitorimi i klorit të lirë dhe e-coli. Inspektorati shëndetësor pritet të marrë analiza të përditshme në zonat urbane dhe të përjavshme në zonat rurale. Inspektorati shëndetësor dorëzon një raport mujor dhe nëse ka probleme, ai njofton menjëherë ndërmarrjen e ujësllësit. Në fund, është përgjegjësi e ndërmarrjes së ujësllësit të sigurojë cilësinë e mirë të ujit. Ndërmarrjet e ujësllësit hedhin klorin manualisht. Në disa raste ato harrojnë ta bëjnë këtë veprim ose nuk hedhin sasinë e përshtatshme të klorit.

92. Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) i kryer për programin e qeverisë thekson rekomandimet e mëposhtme të përgjithshme lidhur me kapacitetin:

- Ka nevojë të përfordhet bashkëpunimi dhe bashkërendimi midis autoriteteve përkatëse të sektorëve të menaxhimit të ujit me autoritetet mjedisore dhe shëndetësore, veçanërisht gjatë planifikimit të infrastrukturës së re për ujësjellës dhe kanalizime.
- Ka nevojë për integrim të mëtejshëm të zbatimit të strategjisë për sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimet me planet vendore për të arritur masat, zbatimin dhe procedurat e parashikuara nga VSM dhe VNM përkatëse.

93. Ndërkohë që vlerësimi thekson fushat ku duhet të fuqizohen kapacitetet, në përgjithësi kapacitetet e institucioneve të programit për zbatimin e sistemeve të MS-të të Programit janë të përshtatshme. Rekomandohet që në AKUM të vendoset personel i MS-së për të mbështetur procesin e shqyrtimit të propozimeve dhe monitorimin e investimeve gjatë zbatimit.

Vlerësimi i masës së përputhshmërisë së sistemeve të zbatueshme me parimet themelore dhe elementet kyçe të planifikimit

95. Parimet Themelore të PpR. Pika 9 e Programit të Politikave të Bankës për Rezultate në Financim përcakton se vlerësimi i sistemeve mjedisore dhe sociale merr në konsideratë, sipas zbatueshmërisë dhe rëndësisë në një vend të veçantë, sektor, ose rrethana të Programit PpR, në çfarë mase Sistemet e Programit PpR:

- a. promovojnë qëndrueshmërinë mjedisore dhe sociale në hartimin e Programit PpR; shmangin, minimizojnë, ose lehtësojnë ndikimet negative, dhe promovojnë vendimmarrjen e informuar lidhur me ndikimet mjedisore dhe sociale të Programit PpR;
- b. shmangin, minimizojnë ose lehtësojnë ndikimet negative në habitatet natyrore dhe burimet kulturore fizike, që vijnë si pasojë e Programit PpR;
- c. mbrojnë sigurinë e publikut dhe punëtorëve ndaj rreziqeve të mundshme që lidhen me: (i) ndërtimin dhe/ose operimin e impianteve dhe praktika të tjera operacionale në kuadër të Programit PpR; (ii) ekspozimin ndaj kimikateve toksike, mbetjeve të rrezikshme, dhe materialeve të tjera të rrezikshme në kudër të Programit PpR; dhe (iii) rikonstruksionin ose rehabilitimin e infrastrukturës që ndodhet në zona të ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore;
- d. menaxhimin e marrjes së tokës dhe humbjen e aksesit në burime natyrore në mënyra që shmangin ose minimizojnë rivendosjen dhe ndihmojnë personat e prekur për të përmirësuar ose të paktën për të rikthyer në gjendjen fillestare jetesën dhe standardet e tyre të jetesës;
- e. marrin në konsideratën e duhur përshtatshmërinë kulturore të, dhe aksesin e barabartë në, përfitimet e Programit të PpR-së, duke i kushtuar vëmendje të veçantë të drejtave dhe interesave të Personave Vendas dhe nevojave dhe shqetësimeve të grupeve të cënueshme; dhe

- f. shmangin përshkallëzimin e konfliktit social, veçanërisht në shtete të brishta, zona që sapo kanë dalë nga konflikti, ose zona lidhur me të cilat ka mosmarrëveshje territoriale.⁷

96. Pjesa më poshtë përmbledh masën në të cilën sistemet janë në përputhje me parimet themelore.

97. Parimi Themelor a. Sistemet e Programit PpR operojnë sipas një kuadri të fuqishëm ligjor që është i modeluar sipas standardeve të BE-së.

98. Në disa aspekte ka prani të mbikëqyrjes së pavarur. ERRU siguron mbikëqyrje të pavarur për rregulloret dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) siguron mbikëqyrje lidhur me vlerësimin e lejeve mjedisore dhe përmbajtjen e VNM-ve. AKM-ja ka në përbërje drejtorinë e inspektoratit mjedisor, që kryen inspektime në terren dhe detyron subjektin të jetë në përputhje me legjislacionin shqiptar për mjedisin dhe standardet e kërkuara. ERRU është njësi e pavarur.

99. Me mbështetjen e GIZ, MIE përgatiti Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) për Strategjinë Kombëtare për Sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2020-2030. Vlerësimi bëri vlerësimin e ndikimeve mjedisore, përfshirë ndikimet e përgjithshme të përparësive të strategjisë lidhur me tematikat e veçanta mjedisore, si Biodiversiteti; Popullsia dhe Shëndeti Njerëzor; Uji, Ndryshimet Klimatike; Toka (menaxhimi i qëndrueshëm, përdorimi i tokës dhe shfrytëzimi i burimeve natyrore); Trashëgimia Kulturore; dhe Peizazhi dhe përcaktoi udhëzime dhe masa lehtësuese për të siguruar arritjen e objektivave mjedisore. VSM-ja arriti në përfundimin se në përgjithësi, hartimi i projekteve të detajuara është në përputhje me praktikën më të mira dhe merr në konsideratë të gjitha masat lehtësuese. Në përgjithësi, shumica e ndikimeve negative lidhen me zbatimin. Ky është edhe rasti për projekte si rehabilitimi apo ndërtimi i strukturave apo sistemeve të Ujësjellës Kanalizimeve. Mundësitë për ndikime negative mjedisore identifikohen në mënyrën e duhur dhe trajtohen në një proces të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Vlerësimit Teknik për zhvillimin e propozuar.

100. VSM-ja ofroi rekomandime nga pikëpamja e ndikimeve të përgjithshme, përfshirë edhe projekte që mund të ndikojnë një zonë të "Natura 2000", që i nënshtrohet kërkesave të përshtatshme të vlerësimit. Sa i përket zonave të mbrojtura, përveç zbatimit të legjislacionit mjedisor dhe praktikave më të mira, kur projektet krijojnë ndikime të konsiderueshme në zonat e mbrojtura dhe për më tepër kur ato ndodhen brenda këtyre zonave, i duhet dhënë përparësi legjislacionit për zonat e mbrojtura. Kjo është me rëndësi për parimin themelor b të PpR-së.

101. Në strukturën e NU-së ka përgjithësisht personel të përshtatshëm në njësinë kryesore administrative, por ka mundësi që njohuritë e tyre për çështjet sektoriale bazë që lidhen me NU-në të përmirësohen. Kufizimet buxhetore theksohen si arsyeja kyçe për mungesën e personelit të kualifikuar të brendshëm për mbulimin e çështjeve të mundshme mjedisore dhe sociale. Qasja e zakonshme ka qenë që zhvilluesi kontraktonte specialistët përkatës në ato raste kur ka mandat të detyrueshëm sipas kontratave të nënshkruara me palë të treta që sigurojnë financim, si KFW, Banka Botërore apo AKUM. Kjo praktikë sugjeron se të pasurit specialistë si pjesë e stafit nuk konsiderohet funksion thelbësor.

⁷ Programit të Politikave të Bankës për Rezultate në Financim OPS5.04-POL.107 Shpallur/Hyrë në Fuqi 10 nëntor 2017

102. NU-të kanë akses në fonde emergjence për ndikime të paparashikuara. Kjo kategori fondesh përdoret zakonisht kur ka defekte të paparashikuara në rrjet, që klasifikohen si me rrezik të lartë për ndotjen e ujit, ose në raste kur stacionet e pompimit pësojnë defekt dhe nuk ka pompa të tjera rezervë për të prodhuar ujin e nevojshëm për klientët. Pasi këto raste klasifikohen si urgjencia NU-së i lejohej të procedohej më tej me përdorimin e fondeve të emergjencës. VSM-ja rekomandon që plotësimi i standardeve mjedisore të shoqërohet me një portofol më të madh financiar dhe investimesh për menaxhimin dhe mbrojtjen mjedisore.

103. Sipas VKM Nr. 379, datë 25.5.2016, Zonat e mbrojtjes sanitare janë të përcaktuara specifikisht për secilin burim, në përputhje me kërkesat e Neneve 34 dhe 57 të Ligjit Nr. 111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore". Ka 3 zona mbrojtjeje sanitare për burimet ujore që lidhen me sistemin e ujësjellësit: a) zonë imediate dhe strikte e mbrojtjes sanitare; b) zona e afërt e mbrojtjes sanitare; c) zona e largët e mbrojtjes sanitare. Për sa kohë që kërkesat dhe detyrimet higjieno-sanitare për zonat e mbrojtura sanitare duhet të respektohen nga administratorët e ujësjellësve, ato duhet të përforcojnë sigurinë dhe të përmbushin kërkesat e VKM-së. Kjo mund të arrihet duke trajnuar punonjësit përgjegjës lidhur me riseduksionimin dhe veprimtarive të lejuara në afërsi të puseve ose burimeve ujore dhe përmes kontrolleve rutinë.

104. Sa i përket reagimit dhe llogaridhënies përmes konsultimit të palëve të interesit, shpërndarjes në kohë të informacionit dhe mekanizmave reagues të ankesave, sistemet e Programit konsiderohen të përshtatshme me mundësi për përmirësim.

105. Një sërë organesh në Program kanë mekanizma të aksesueshëm ankesash me procedura të përcaktuara për ngritjen e ankesave. Për shembull, ERRU ka rutina dhe standarde të përcaktuara për mënyrën se si i përgjigjet ankesave të marra. Procedura e ERRU përfshin marrjen e ankesës dhe diskutimin në komision. Gjatë vitit kalendarik 2019, deri më 11.4.2019, ERRU kishte marrë 50 ankesa dhe mbështeti klientët në një rol ndërmjetësi me ndërmarrjet e ujësjellësit lidhur me tarifat. Ndërkohë që ERRU regjistron çdo ankesë në një dosje të veçantë, ankesat nuk janë të digjitalizuara. Ankesat përmbledhen në raportimin e tyre vjetor.

106. AKUM ka një formular ankesash në faqen e tyre të internetit që i referohet Ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit". Ndërkohë që regjistrat janë në faqen e tyre të internetit, regjistri i MTA 2017 pasqyron një ankesë, ai për vitin 2018 pasqyron shtatë (një prej të cilave kishte të bënte me procesin e shpronësimit) dhe dokumenti i vitit 2019 i shkarkuar më 12 dhjetor 2019 dokumenton dy ankesa. Mungesa e ankesave mund të sugjerojë mungesë të ndërgjegjësimit lidhur me procesin, pengesa në akses, ose mbase regjistrim të ankesave të palëve të interesuara të regjistruara diku tjetër. Standardet për kthim përgjigje ankesave nuk janë të bërë publike.

107. Portali i Konsoliduar i Shërbimit të Klientit, <https://www.shuk.al/>, ngrihet deri në janar 2020 dhe vihen në funksion deri në mars 2020. GIZ në bashkëpunim me ERRU synon të unifikojë faqen për ta standardizuar për të gjitha pretendimet e klientëve që i referohen shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Faqja e internetit është e krijuar për secilën. NUK-të kanë detyrimin të caktojnë një person që do të jetë përgjegjës për menaxhimin e e faqes nga ana e NU-së dhe për të trajtuar pretendimet në drejtoritë përkatëse. Të gjitha ankesat e ngarkuara në faqen e internetit shkojnë drejtpërsëdrejti tek NU-të përkatëse. Faqja e internetit është e organizuar për të regjistruar ankesën në drejtorinë përgjegjëse dhe është e ndarë për shërbimin e furnizimit me ujë dhe atë të kanalizimeve. Klienti njoftohet pasi pretendimi është ngarkuar me sukses në portal. Në fund, përgjigja varet nga shkalla e llogaridhënies së NU-së

karshi klientit. Objektivi i sistemit është të klasifikojë NU-të sipas përgjigjeve që i japin ankesave të klientëve. GIZ po ofron asistencë teknike për përgjigjen ndaj klientëve.

108. Portali i Shërbimit për Klientin kërkon që klientët të paraqesin mjetin e tyre të identifikimit për të bërë faqen e internetit më zyrtare dhe më të besueshme. Shoqata planifikon të krijojë një sistem që mbledh të gjitha ankesat nga të gjitha burimet dhe i hedh ato në këtë platformë për të unifikuar standardin. Në të ardhmen sistemi mund të përdoret si variabël lidhur me performancën e NUK-së.

109. Parimi Themelor b i lidhur me shmangien, minimizimin dhe lehtësimin e ndikimeve negative në habitatet natyrore dhe burimet fizike të kulturës, sepse Program PpR vlerëson sistemet e menaxhimit të MS-së si të përshtatshme. Lloji i veprimtarive të mbështetura në kuadër të Programit PpR nuk parashikohen të përfshijnë transformim ose degradim të habitateve natyrore kritike apo të trashëgimisë kulturore fizike kritike.

110. Përveç legjislacionit që lidhet veçanërisht me nevojën për ndërmarrjen e VNM-së, legjislacioni tjetër i fushës së mjedisit është në përputhje me Direktivat e Komisionit Evropian. Standardet ekzistuese përfshijnë mbrojtjen e biodiversitetit; trashëgimisë kulturore, shkarkimet në ajër; nivelin e zhurmave; cilësinë e ujit dhe shkarkimet në të; dhe menaxhimin e mbetjeve. Ligji i vitit 2000 për Mbrojtjen e Mjedisit përcakton kërkesat për mbrojtjen mjedisore, përfshirë kërkesën për ndërmarrjen e një Vlerësimi të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe marrjen e një deklaratë mjedisore përpara fillimit të një projekti. Ai përcakton kërkesat e monitorimit për të identifikuar ndikimet e projektit gjatë funksionimit dhe kërkesat e rehabilitimit gjatë fazës përmbyllëse të projektit. Ligji u ndryshuar në vitin 2011 për të trajtuar Direktivat e Bashkimit Evropian (përfshirë Direktivën e BE 2011/92/BE) dhe praktikën më të mirë lidhur me menaxhimin e mjedisit. Ligji i vitit 2011 për Mbrojtjen e Mjedisit përcakton kuadrin e mbrojtjes së mjedisit, kuadrin dhe kompetencat institucionale, parimet e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe të lejeve mjedisore. Ai përcakton veprimtaritë që ndikojnë në mjedis si “çdo veprimtari ekonomike apo shoqërore që përdor mjedisin apo një pjesë të tij, ose që shkarkon materiale dhe energji duke ndryshuar tiparet e mjedisit”. Të gjitha projektet me ndikim të mundshëm në mjedis ndërmarrin një Vlerësim të Ndikimit në Mjedis përpara se të nisin zbatimin. Raporti i VNM-së dhe dokumentacioni tjetër i nevojshëm i dorëzohet Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit që ia transferon dokumentacionin e projektit Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për shqyrtim. Projekti miratohet me Vendim/Deklaratë Mjedisore të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Procedura e VNM-së detajohet në VKM Nr. 686 datë 29.07.2015 “Miratimi i rregullave, përgjegjësisë dhe afatit të procedurës për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

111. Në kuadër të programit qeveritar për Biodiversitetin, rekomandohet si udhëzim i përgjithshëm që të organizohet konsultim i hershëm me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe agjencinë e saj për zonat mjedisore dhe të mbrojtura. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur planifikohen struktura të reja, duke eliminuar praktika që në të shkuarën kanë sjellë ndikime të pakthyeshme në zonat e mbrojtura dhe shkelje të legjislacionit. Me qëllim ruajtjen e mjedisit natyror dhe biodiversitetit, zbatohen masat e mëposhtme:

- Përdorimi i infrastrukturës ekzistuese ka përparësi mbi ndërtimin e infrastrukturës së re për furnizimin me ujë dhe shërbimet sanitare;
- Veprimtaritë në zonat e mbrojtura, zonat me rëndësi mjedisore dhe zonat me tipare natyrore me vlerë duhet të shmangen;

- Marrin përparësi variantet me ndikimin më të pakët në shtigjet e migrimit të kafshëve të egra (variantet që kalojnë më shumë përmes tuneleve dhe variante që kryqëzohen më pak me shtigje migrimi);
- Duhet të sigurohen shtigje kalimi të përshtatshme për kafshët e egra, çka është në përputhje me praktikën më të mirë evropiane. Përpara planifikimit të ndërtimeve të reja, duhet të ndërmerret një studim, ose duhet të përmbliidhen rezultatet e studimeve ekzistuese, kjo do të lehtësonte integrimin e duhur të një strukture përkatëse në një vend (forma përmasat, dhe sistemimi i objektit në mjedisin që e rrethon). Projektet duhet të sigurojnë edhe shtigje për kafshët e vogla (amfibët, gjitarët e vegjël, zvarranikët) bazuar në studime ekzistuese, ose në kërkime shtesë, nëse është e nevojshme.

112. Sa i përket ndikimeve mbi burimet natyrore, VSM ka arritur në përfundimin se veprimtaritë e ndërtimit në përgjithësi (rikonstruksione apo ndërtime të reja) janë burim i sasive të mëdha të mbetjeve dhe krijojnë presion në përdorimin e burimeve natyrore. Mbetjet krijohen jo vetëm për periudha të përkohshme gjatë fazës së ndërtimit, por edhe vazhdimisht gjatë fazës së operimit, si dhe në kuadër të proceseve të mirëmbajtjes së strukturave. Ndikimi nga krijimi i mbetjeve të ndërtimit është i përhershëm dhe në shumë raste i pakthyesëm, sa i përket ndikimit në burimet natyrore. Kështu, ndikimi negativ në mjedis duhet të reduktohet përmes masave për menaxhimin e mbetjeve. Kur merret në konsideratë mënyra se si prodhohen dhe lloji i strukturës, sasia e mbetjeve të prodhuara nga zhvillimet infrastrukturore në nivel vendor pritet të jenë më të lokalizuara dhe të menaxhueshme më lehtë. Me qëllim sigurimin e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, VSM-ja rekomandon që projektet e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve do të duhet të shoqërohen me udhëzime për promovimin e riciklimit dhe ripërdorimit të mbetjeve të ndërtimit për ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës së re, dhe çka është më e rëndësishmja, të përdorimit të materialeve të certifikuara të ndërtimit të prodhuara nga riciklimi i materialeve të mbetura apo mbetjeve nga sektorë të tjerë.

113. Ligji Nr. 10119/09 që hyri në fuqi më 30.11.2011, synon të përcaktojë zhvillim të qëndrueshëm të territorit përmes përdorimit racional të tokës dhe burimeve natyrore. Ky ligj përfshin konceptet e mbrojtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore dhe mbrojtjen e shëndetit dhe të sigurisë të komunitetit. Ligji dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij kërkojnë deklaratë për të gjitha llojet e ndërtimeve. Afatet e zbatimit të projektit; mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, dhe shëndeti dhe siguria e komunitetit përfshihen në masat lehtësuese të VNM-së. Ligji 27/2018 (17.05.2018) Të gjitha çështjet që lidhen me trashëgiminë kulturore në Shqipëri rregullohen nga ky ligj. Ligji përcakton ruajtjen dhe procedurat për gjetjet e rastit (objekte arkeologjike ose sende me vlerë për trashëgiminë kulturore, të cilat zbulohen rastësisht) që duhet të zbatohen gjatë zbatimit të Projektit. Monumentet e kulturës që ndodhen përreth zonës së projektit duhet të identifikohen. Neni 146 i ligjit kërkon dhe detyron të gjithë personat që zbulojnë ose gërmojnë rastësisht objekte me vlerë për trashëgiminë kulturore, të pezullojnë menjëherë punën dhe të informojnë autoritetet vendore përkatëse brenda tre ditëve.

114. Autoritetet përkatëse vendore përbëhen nga zyra e qeverisjes vendore (bashkia), Drejtoria e Policisë dhe Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK). DRTK verifikon situatën/gjetjet dhe i raporton Institutit të Monumenteve të Kulturës (IMK). Këto institucione janë përgjegjëse për vlerësimin e vlerës arkeologjike të objekteve të gjetura dhe për përcaktimin e vazhdimin të punimeve apo nëse punimet duhet të vijojnë të pezullohen deri në përfundim të hulumtimeve të mëtejshme në terren. Procedurat për gjetjet rastësore duhet të hartohen dhe zbatohen gjatë ndërtimit, dhe në rastin e një gjetje rastësore autoritetet duhet të njoftohen sipas

kërkesave. Autoritetet vendore përgjegjëse për ruajtjen, restaurimin dhe menaxhimin e monumenteve të kulturës janë DRTK-të në varësi të Ministrisë së Kulturës.

115. Sa i përket trashëgimisë kulturore, VSM-ja thekson se zhvillimi i infrastrukturës për Furnizimin me Ujë dhe Kanalizimet mund të ndikojë njësitë dhe zonat kulturore, veçanërisht sa i përket degradimit të tipareve të peizazhit përreth vendeve të trashëgimisë kulturore, të dëmtojë vendet e trashëgimisë kulturore, dhe të shkatërrojë rrënojat arkeologjike gjatë ndërtimit të strukturave, që mund të shkaktojnë dëme në vendet e trashëgimisë kulturore. Me qëllim shmangien e këtyre ndikimeve VSM-ja propozon marrjen në konsideratë, sa më poshtë:

- Të mos i jepet përparësi infrastrukturës së re (përfshirë rrugët lidhës) në zonat e trashëgimisë kulturore. Në veçanti, duhet të ruhen integriteti dhe tiparet e peizazheve kulturore, vendeve të trashëgimisë arkeologjike dhe rrënojat arkeologjike.

- Në kontekstin e ruajtjes së rrënojave arkeologjike dhe/ose vendeve të trashëgimisë kulturore, veprimtaritë në mjedis konsiderohen si akte shkatërrimi (p.sh gërmimi). Do të duhet të ndërmerren një sërë hulumtimesh paraprake, rezultati i të cilave do të duhet të merret në konsideratë për përcaktimin e vendosjes së infrastrukturës së propozuar të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve. Duhet të zbatohen edhe masa për ruajtjen e rrënojave arkeologjike dhe/ose vendeve të trashëgimisë kulturore.

- Gjetjet me rëndësi madhore mund të kërkojnë ndryshimin e punimeve përgatitore (projekti) për detyra të veçanta. Në rast të zbulimit të gjetjeve apo rrënojave arkeologjike, autoriteti kompetent njoftohet menjëherë. Më pas zona studiohet dhe ka mundësi të rrethohet duke parandaluar të gjitha zhvillimet e mëtejshme në zonë derisa çështja të jetë zgjidhur sipas procedurës së përcaktuar.

- Të gjitha punimet e ndërtimit kufizohen në korridorin e punimeve. Nëse nevojitet më shumë hapësirë ose veprimtari që lidhen me punimet e ndërtimit jashtë korridorit, autoritetet përkatëse njoftohen paraprakisht.

116. Ligji 9048 ("Ligji për Trashëgiminë Kulturore") i miratuar më 7 prill 2003 (ndryshuar me ligjin nr 9592, datë 27.07.2006; Ligjin nr 9882, datë 28.02.2008) është kuadri kryesor ligjor që rregullon menaxhimin e pasurive kulturore materiale dhe jomateriale në Shqipëri. Ligji 9048 përfaqëson përpjekjen e parë për të zgjeruar mbrojtjen ligjore në fushën e trashëgimisë kulturore jomateriale. Përmbajtja e tij përfshin: Kategoritë e trashëgimisë kulturore shqiptare që duhet të mbrohen (pra, materiale, jomateriale, e luajtshme, e paluajtshme); Përkufizimet dhe shembuj të trashëgimisë materiale dhe jomateriale; Përgjegjësitë e institucioneve dhe organeve shtetërore përkatëse; Penalitetet për ata që dëmtojnë trashëgiminë kulturore; dhe Procedurat e lehtësimit. Neni 4 renditë vlerat materiale të paluajtshme për t'u mbrojtur, që përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në: Vendet arkeologjike; Struktura historike (duke përfshirë vendet e adhurimit); Qytetet dhe lagjet historike; Varrezat dhe varre dhe Peizazhet historike. Ligji 9048 u ndryshua me ligjin nr 9592, datë 27.07.2006. Ndryshimet përfshinin 1) paraqitjen e Komitetit Kombëtar të Trashëgimisë Kombëtare si organ këshillues dhe 2) krijimin e Komitetit Kombëtar për Trashëgiminë Jomateriale (KKTJ). Ligji 9048 u ndryshua përsëri me ligjin nr 9882, datë 28.02.2008. Ndryshimet e vitit 2008 përfshinë nene që rikrijuan rrjetin e institucioneve të specializuara për trashëgiminë kulturore dhe nene që trajtonin krijimin e Këshillit Kombëtar të

Arkeologjisë me institucione të specializuara si Shërbimin Arkeologjik Shqiptar. Sipas këtij ligji, nëse gjatë procesit të gërmimit zbulohet diçka e pazakontë, kontraktori duhet të ndërpresë menjëherë punën, duhet të informojë autoritetet vendore, Institutin e Monumenteve të Kulturës dhe gjithashtu edhe Ministrinë e Kulturës. Ata dërgojnë arkeologë dhe specialistë të fushës terren për të kontrolluar dhe vlerësuar objektet e supozuara arkeologjike dhe punimet do të rifillojnë vetëm pas lejes zyrtare të dhënë nga Instituti i Monumenteve të Kulturës.

Sa i përket projekteve të financuara me fonde ndërkombëtare, bazuar në marrëveshjet e kontratës, zhvilluesi duhet të respektojë gjithashtu detyrimet ndërkombëtare të përcaktuara në konventa dhe marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria në kuadrin e trashëgimisë kulturore. Këto përfshijnë:

Ligjin Nr. 9490 “Për ratifikimin e Konventës për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale”, Paris 2003, ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2006.

Ligjin Nr. 9806, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane “Për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike”, ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2007.

Ligji Nr. 10027 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Nënujore”, Paris 2001, ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2008. Personeli i ndërmarrjeve të ujësjellësit të intervistuar ishin të aftë të citonin ligjet e zbatueshme dhe procedurat që lidhen me shmangien, pakësimin ose lehtësimin e efekteve në pronat kulturore fizike. Në Elbasan dhe Gjirokastrë, inxhinierët e ndërmarrjeve të ujësjellësit theksuan se artefaktet kulturore që hasen më shpesh lidhen me shqetësimin e kalldrëmeve në pjesët e vjetra të qytetit. Ministri i Kulturës mund të shpallë zona me rëndësi monumentale. Pas gjetjeve rastësore, personeli ndërpret projektin dhe njofton drejtorin përgjegjës dhe kërkon udhëzime (a do të ishte e udhës të përfshihej një shembull nga Elbasan apo Gjirokastra ku e bëjnë faktikisht një gjë të tillë)

117. Sa i përket gropave septike dhe gropave me kullim ka mungesë legjislativi. Gjithashtu, ndërmarrjet e ujësjellësit nuk kanë një sistem të përshtatshëm për mbledhjen dhe administrimin e ujërave të ndotura që mbledhen në gropa septike. Ka një rrezik që lidhet me investimet e mundshme që mbështesin bashkitë në zbatimin e këtyre veprimtarive. Nëse Programi vendos të mbështesë subvencione për këto lloje veprimtarish, duhet të zbatohen një mekanizëm për sigurimin e cilësisë dhe mbase një proces për marrëveshjen/inspektimin e mirëmbajtjes.

118. Parimi Themelor c. Lidhur me mbrojtjen e sigurisë së publikut dhe punëtorëve. Legjislativi shqiptar përcakton themelet për konsideratat bazë Qasja duhet të përkufizohet dhe të integrohet në VNM dhe duhet të kërkohet një PMMS. Kuadri ligjor ekzistues dhe Inspektorati i Punës i Autoriteteve Shqiptare kanë ratifikuar 53 konventa të ILO-s dhe 48 prej tyre janë në fuqi. Sa i përket Shëndetit dhe Sigurisë në punë, ato mund të ndikohet nga ndikimet e mundshme nga rreziqet /aksidentet gjatë dhe pas ndërtimit dhe nga sëmundjet si pasojë e mbetjeve të materialeve të rrezikshme të ndërtimit. Sa i përket Shëndetit dhe Sigurisë së Komunitetit, ato mund të ndikohen nga Ndikimet e mundshme si Aksidentet dhe dëmtimet e publikut në afërsi të kantierit, dhe nga ndotja e mundshme e zhurmës dhe dritës në zona të veçanta të ndërtimit. Me qëllim minimizimit të rreziqeve, duhet të angazhohen kontraktorë me përvojë dhe në dokumentet e kontratave duhet të përfshihen kërkesa sigurie dhe mjedisore. Qëllimi i Kodit të Sjelljes është të ofrojë udhëzime për të gjithë punonjësit (përfshirë ata të nënkontraktorëve) lidhur me sjelljen që pritet prej tyre nga Shoqëria në vendin e punës, dhe për mënyrën si duhet të sillen me palët e interesit të Projektit (punonjësit, klientët, furnitorët dhe anëtarët e publikut). Objekti i Kodit të Sjelljes do të përcaktojë angazhimet e menaxhimit të

Shoqërisë, vlerat dhe parimet themelore të operimit. Kodi i referohet planeve të tjera përkatëse të menaxhimit (p.sh atij të Sigurisë dhe Shëndetit Publik).

119. Sa i përket mbrojtjes së sigurisë së publikut dhe punëtorëve, Ligji Nr. 10237/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” garanton sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit përmes parandalimit të rreziqeve që lidhen me punën, duke eliminuar faktorët që përbëjnë rrezik për aksidente, duke informuar, këshilluar dhe ekuilibruar pjesëmarrjen në përputhje me ligjin.

120. Zbatimi i projekteve të UK-ve mund të ketë ndikime të përkohshme vendore negative për shëndetin e njeriut. Ndikimet negative mund të përfshijnë veçanërisht shqetësimet lidhur me ndikimet nga zhurma dhe cilësia e ajrit që krijohen nga lëvizja e mjeteve të punës apo makinerive të rënda, për shembull. Ndërkohë që mundësia për ndikime negative në shëndetin njerëzor varet nga shkalla dhe lloji i propozimeve në të ardhmen, si dhe nga vendndodhja e tyre (sa i përket distancës nga popullsia e ndjeshme dhe tiparet aktuale mjedisore, si cilësia e ajrit), punimet do të jenë të natyrës rehabilituese dhe të përkohshme, dhe ka gjasa që ndikimet të menaxhohen/lehtësohen bazuar në praktikatat më të mira të mbrojtjes mjedisore. Nuk pritet që efektet negative të jenë të konsiderueshme.

121. Çdo vit, NU-ja zhvillon një trajnim formal për rregulloret teknike të sigurisë. Zakonisht, kjo procedurë ndiqet nga një kryeinxhinier i NU-së dhe është kërkesë ligjore që duhet të dokumentohet.

122. Bazuar në kampionet e analizave të raporteve të monitorimit të ujit të pijshëm të kryera rregullisht nga Instituti i Shëndetit Publik, disa pika në rrjet (veçanërisht në zonat rurale), rezultatet tregojnë se klori i lirë nuk është në përputhje me vlerat e lejuara sipas VKM-së “Për Cilësinë e Ujit të Pijshëm”. Këto problematika me parametrat mund të shkaktohen nga një sërë faktorësh që lidhen me matjen manuale nga ana e personelit me trajnim të kufizuar. Zgjidhja më e mirë për shmangien e këtyre rasteve do të ishte instalimi i sistemeve automatike të pompimit të klorit.

123. Parimi Themelor d. Sa i përket menaxhimit të marrjes së tokës dhe humbjes së aksesit në burime natyrore në mënyrë të tillë që shmang ose minimizon rivendosjen dhe ndihmon personat e prekur për të përmirësuar, ose për të kthyer të paktën në gjendje fillestare, jetesën dhe standardet e tyre të jetës, sistemet e Programit PpR u konsideruan disi të përshtatshme. Në kuadër të Programit, parashikohet të ketë nevojë për marrjen e përhershme të tokës për zgjerimin e tubacionit të ri të ujit dhe mund të nevojitet dhe marrje e përkohshme e tokës, megjithëse projektimi zakonisht bëhet për të shmangur sa më shumë të jetë e mundur marrjen e tokës. Në shumicën e investimeve të planifikuara në kuadër të operacionit që lidhet me rehabilitimin e tubacionit, parashikohet të mos ketë nevojë për marrje toke.

124. Në ato raste kur marrja e tokës është e nevojshme për punimet e ndërtimit, organi zbatues i projektit ofron menaxhim të rrezikut social, bazuar në udhëzimet e organit që siguron financimin. Sa i përket projekteve të financuara me fonde të qeverisë shqiptare, procedura e shpronësimit përshkruhet në Ligjin shqiptar për shpronësimin, të ndryshuar me Ligjin Nr. 20/2016, datë 10.03.2016 dhe me ndryshimet e muajit shkurt 2020, dhe ndryshimet qartësojë përdorimin e procedurave të IFN-ve nëse financimi sigurohet nga IFN. Ky ligj rregullon të drejtën

e shtetit për të shpronësuar ose për të marrë në përdorim të përkohshëm për interes publik prona të personave fizikë apo organeve private, si dhe për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e pronarëve të tyre përkatës ligjorë.

125. Ligji njih të drejtën e kompensimit vetëm për personat e prekur (PP) që kanë të drejta ligjore formale. Në rastet kur PP-të janë identifikuar, por nuk janë pronarë të ligjshëm, i mbetet vullnetit dhe kapaciteteve të bashkisë për të ofruar një zgjidhje apo marrëveshje të përkohshme. Ligji shqiptar për shpronësimin nuk përfshin kompensimin në natyrë dhe kështu dispozita e strehimit të përshtatshëm me sigurinë e posedimit nuk është e nevojshme. Kompensimi ofrohet në vlerë monetare dhe çmimet publikohen në VKM 89, datë 03/02/2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”. Duke qenë se çmimet janë të vitit 2016, ato mund të mos pasqyrojnë vlerën aktuale të tokës ose koston e zëvendësimit. Në mars të vitit 2020, ndryshimet dhe shtesat në Ligjin Nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen e përkohshme të pronës private për interes publik”, u miratuan me qëllim që procesi i marrjes së tokës të ishte në përputhje me marrëveshjen ndërkombëtare për investimet e financuara nga IFN. Në programin PpR do të propozohet zbatimi i standardeve ESS5 për kompensimin e PP-ve, sipas nenit 17 të Ligjit për Shpronësimin dhe për marrjen e e përkohshme të pronës private.

126. Shpallja e informacionit dhe informacioni publik në kuadër të Ligjit për shpronësimet në Shqipëri, detyron ministrinë e linjës të njoftojë PP-në drejtpërsëdrejti dhe të botojë aplikimin për shpronësim në gazetën zyrtare për një javë të tërë, si dhe ta botojë në gazeta kombëtare dhe vendore. Brenda 15 ditëve nga data e fundit e shpalljes, PP-ja duhet të informojë ministrinë lidhur me pretendimet e tyre që lidhen me pronat e prekura nga shpronësimi. Përveç njoftimit të personave të prekur, nuk ka kërkesa të tjera për konsultimin dhe shpalljen publike të dokumentacionit. Legjislacioni shqiptar për shpronësimin siguron të drejtën e PP-së për të mobilizuar gjykatën me qëllim kërkesën për vlerë më të lartë shpronësimi nga ajo e përcaktuar në vendimin për shpronësim të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, por PP-ja nuk mund të kundërshtojë procesin e shpronësimit. Pretendimet e ngritura nuk sjellin pezullim të procesit të shpronësimit, megjithëse rezultati mund të jetë një vlerë më e madhe kompensimi që duhet paguar, nëse vendoset kështu nga gjykata kompetente. Megjithëse në legjislacionin shqiptar nuk ka kërkesa për ngritjen e një sistemi jashtëgjyqësor për ankesat, kjo nuk është në kundërshtim me procesin e përcaktuar në legjislacionin shqiptar, për sa kohë që PP-ja mund të ushtrojë të drejtën e vet kushtetuese për të ngritur pretendimet e veta në gjykatën kompetente, sipas vlerësimit të vet. Nuk ka legjislacion të veçantë shqiptar që përcakton asistencë shtesë për PP-të.

127. Gjatë përgatitjes së projektit, ndërmarrja e ujit kontrollon zonën e projektit për të përcaktuar nëse marrje të paqëllimshme të tokës dhe nëse do të ketë nevojë për rivendosje të banesave apo bizneseve. Në kuadër të procesit të shpronësimit janë të nevojshme dokumentet kadastrale. Ligji nuk përcakton kompensimin e personave të cilët mund të mos gëzojnë të drejta të plota ligjore lidhur me burimet që ata përdorin ose kanë zënë. Ligji nuk përcakton as kompensimin e mjaftueshëm për të blerë asete zëvendësuese me vlerë të barabartë dhe për të plotësuar të gjitha shpenzimet e nevojshme tranzitore të personave që mund të mos gëzojnë të drejta ligjore mbi asetet dhe tokën që kanë zënë. Për shembull, në Elbasan formalizimi i një zone informale kërkonte marrjen e tokës ku banonin persona pa tituj pronësie. Në këtë rast u shpjegua se për raste të tilla mund të subvencionohet pagesa e qirasë për disa muaj ose banorët mund të mbështeten për të ngritur pretendime të ligjshme lidhur me tokën, por kjo bëhet

rast pas rasti. Në kuadër të programit PpR do të propozohet një procedurë e përmirësuar kontrolli. Kontrolli nuk do të bëhet vetëm për dokumentet kadastrale, por edhe lidhur me vëzhgimin fizik të të gjitha aseteve të ligjshme apo të paligjshme, si edhe për konsultimin publik.

128. Gjatë procesit të kontrollit mund të ketë edhe raste të ndryshimit të statusit. AKUM ka informuar lidhur me raste kur gjatë procesit të miratimit është arritur në përfundimin se nuk ka nevojë për marrje toke, sipas aplikimit i bashkisë/NU-së, dhe ma pas ka pasur ndryshime në statusin pronësor të tokës, ose është vërtetuar se toka është përdorur në mënyrë jo zyrtare nga përdorues, situata e të cilëve ka shkaktuar vonesa në zbatim. Kur gjatë procesit të miratimit përcaktohet se nuk ka nevojë për marrje toke, nuk sigurohen fonde për kompensim. Çdo nevojë për marrje toke që del gjatë zbatimit shkaktton vonesa në zbatimin e projektit. Kontrolli fizik në terren që shoqëron konsultimin në vend minimizon rrezikun e paparashikueshmërisë të vlerësimit të nevojave për marrjen e tokës përpara zbatimit.

129. Ka pasur raste kur toka publike nuk është rehabilituar në gjendje fillestare pas përfundimit të punimeve. Për shembull, Rasti i Durrësit lidhur me operimin e FIP-së thekson mospërputhjen me kërkesat e Bankës në kuadër të Financimit për Investimin në Projekt, duke qenë se një rrugë nuk është rehabilituar plotësisht pas riparimit të tubave. Publiku do të informohet lidhur me detyrimin për të rehabilituar kantieret në kushtet e tyre origjinale. Kjo do të rriste trysninë për të kryer rehabilitimin në gjendje fillestare pas punimeve, nëse ky rehabilitim nuk është kryer.

130. Parimi Themelor e. Rehabilitimi i sistemit të furnizimit me ujë do të sillte instalimin e matësve dhe legalizimin e lidhjeve informale. Në rastet kur përdoruesit informalë janë familje të trajtuar me ndihmë ekonomike / nën kufirin e varfërisë që përfiton ndihmë ekonomike, përdoruesit përfitojnë lidhje pa pagesë si dhe një volum prej 20 litrash për person për ditë. Mundësitë sigurohen nga bashkitë, sipas kodit të furnizimit me ujë.

Seksioni IV. Rekomandime dhe Veprime

Informacion për Planin e Veprimit të Programit (PVP)

Bazuar në analizën e mësipërme, seksioni më poshtë përmbledh sistemet kyçe dhe mangësitë në performancë, dhe propozon veprimet e mëposhtme si masa për Programin PpR. Veprime të PVP-së për të përmirësuar performancën e sistemit.

Sistemet Kyçe dhe Mangësitë në Performancë

132. Sa i përket sistemeve mjedisore dhe mangësive në performancë, VSMS-ja identifikoi dobësitë dhe mangësitë në përputhje nga ana e ndërmarrjeve të UK-së lidhur me detyrimin e tyre për të kryer monitorim cilësor të ujit. Sipas kuadrit ligjor, VKM Nr. 379 datë 25.5.2016 “Për miratimin e rregullores “për cilësinë e ujit të pijshëm”, është baza e legjislacionit kombëtar që i kërkon NUK-ve të plotësojnë kriteret e përcaktuara në shtojcat e VKM-së. Sipas kësaj VKM-je dhe akteve të tjera, ndërmarrjet e ujësjellësit kanë kërkesën ligjore për të analizuar ujin e pijshëm. Megjithatë, shumë prej tyre nuk kanë aftësi të brendshme për ta bërë këtë. Kjo është një mangësi midis ligjit dhe performancës së tyre, që duhet të trajtohet. Alternativat për t’u përputhur me këtë rregullore shkojnë nga kontraktimi i një laboratorit të regjistruar tek ngritja e kapaciteteve të brendshme, në kuadër të përmirësimit të përgjithshëm të performancës së ndërmarrjes së ujësjellësit. Cilësia e ujit duhet të verifikohet për lidhjet e reja që po zbatohen në kuadër të Programit për të cilat po bëhen disbursime nga TLD 5 për lidhjet e reja funksionale të furnizimit familjar me ujë.

133. Ndërkohë që palët e konsultuara në kuadër të procesit të përgatitjes së VSMS-së përmendën rreziqe të mundshme që lidheshin me praninë e asbestit në tubat prej çimento të sistemeve të furnizimit me ujë, BB nuk ka arritur të mbledhë të dhëna sasiore për praninë e vendndodhjeve me tuba me asbest në infrastrukturën e AKUM-it apo NU-ve që konfirmon praninë e asbestit në tubacion. Nga pikëpamja e menaxhimit të rrezikut dhe sigurisë së punonjësve, ky informacion duhet të jetë i disponueshëm.

134. Sa i përket performancës së menaxhimit të rreziqeve sociale dhe mangësive në sistem, gjatë diskutimeve të mbajtura me krerët e drejtorisë së kontrollit teknik, personeli i AKUM-it shpjegoi se rreziku kryesor i mundshëm gjatë kontrollit të projektit janë problematikat sociale që lidhen me identifikimin e shpronësimeve. Sa i përket marrjes së tokës, mangësitë kryesore të sistemit lidhen me mosnjohjen e atyre që nuk janë pronarë toke, dhe me kompensimin e kryer bazuar në lista reference të papërditësuara për pronarët e ligjshëm, çka përbën mangësi në performancë. Legjislacioni shqiptar përmes njoftimit për PP-në nuk ka kërkesa të tjera për konsultimin dhe shpalljen publike të dokumentacionit, dhe nuk merr në konsideratë kostot e transaksionit, dhe gjithashtu përcakton se zhvlerësimi duhet të merret në konsideratë nëse objektet merre/zhvendosen, që nuk është në përputhje me kërkesën e “vlerës standarde të zëvendësimit”.

135. Aktualisht, AKUM-i nuk ka personel me përvojë në MS për të shqyrtuar propozimet infrastrukturore apo kryerjen sistematike të monitorimit dhe vlerësimit. Duke qenë se kjo është një veprimtari e re për AKUM-in, duhet të ketë personel dhe PSV përpara se të nis investimet.

136. Legjislacioni kombëtar njeh vetëm personat e prekur që kanë të drejta ligjore formale. Humbja e jetesës nuk njihet në kuadër të marrjes së tokës, dhe humbja e aksesit fizik në burime natyrore nuk trajtohet shprehimisht.

137. Mangësi në kontrollin dhe verifikimin e pronarëve të mundshëm të tokës: Bazuar në përvojën e AKUM-it lidhur me shpronësimin e tokës, ka raste në të cilat bashkitë kanë lëshuar një dokument zyrtar që thotë se gjurma e projektit nuk ka nevojë për shpronësim, dhe pasi projekti ka nisur, pronarët e ligjshëm janë identifikuar si persona të prekur nga zbatimi i projektit. Kjo çështje u përmend gjithashtu në mbledhjet me NU-të. Për shembull Ndërmarrja e Durrësit u hodh në gjyq për një rast shpronësimi. Pas zbatimit të një projekti që kishte të bënte me ndërtimin e një rezervuari uji në Fushë Krujë, (Projekt i financuar dhe menaxhuar nga AKUM) pronari i tokës nuk u identifikua/shpronësua në fazat e hershme të projektit. Dy vjet pas zbatimit të projektit, NU-ja është e përfshirë në një proces ligjor me pronarin e ligjshëm të pronës. Bazuar në këtë përvojë, drejtoria e kontrollit teknik sugjeron që kriteret e kontrollit duhet të përditësohen dhe të fuqizojnë përgjegjësitë e autoriteteve përkatëse për të verifikuar me kujdes çështjet mjedisore dhe sociale.

138. Në listën e kontrollit të zbatuar për projektin nga AKUM, nuk ka një kërkesë për studim VNM gjatë fazës së kontrollit të propozimeve të projektit, megjithatë përpara lëshimit të lejes së ndërtimit, bashkia kërkon një raport dhe deklaratë të VNM-së. Në mënyrë që të sigurohet ndërmarrja e procedurës së VNM-së për projektin dhe fuqizimi i politikave të mbrojtjes mjedisore, rekomandohet të shtohet kërkesa për një procedurë VNM si pjesë e kriteve të kontrollit, për sa kohë që Ligji 10440 datë 07/07/2011 për procedurën dhe kërkesat e VNM-së, kërkon që zhvilluesi të përgatisë një studim VNM në fazat e hershme të projektit, gjatë studimit të realizueshmërisë.

Veprimet e Rekomanduara në Kudër të PVP-së

139. Me qëllim sigurimin e ndihmës për ngritjen e kapaciteteve në AKUM, personeli i MS-së duhet të jetë pjesë e ekipit të shqyrtimit të projekt propozimeve dhe pjesë e njësisë që monitoron procesin e zbatimit të investimit. Personeli duhet të trajnohet për të shqyrtuar investimeve që do të konsideroheshin të pranueshme për disbursim, dhe atyre do t'u ofrohet trajnim nga BB-ja lidhur me politikën dhe strategjitë e Programit PpR, në mënyrë që të jenë më të njohur me natyrën e projektit, duke qenë se do të jenë pjesë e mbështetjes së zbatimit. Ngarkesa e përllogaritur e punës prej rreth 15-25 investime në vit konsiderohet si e përbalueshme nga dy punonjës MS. Në Shtojcën C jepet një shembull përshkrimi pune për pozicionin.

140. Me qëllim përforcimin e menaxhimit të rreziqeve që lidhen me heqjen e tubave me asbest, në kuadër të propozimit të projektit që dorëzohet nga ndërmarrja e ujësjellësit, kjo e fundit duhet të përcaktojë nëse investimi përfshin zëvendësimin e tubave me asbest dhe duhet të dorëzojë një plan për sigurinë publike të punëtorëve lidhur me heqjen e tubave me asbest, si dhe protokollet për zëvendësimin, në përputhje me (Rregulloren e nevojshme për shmangien dhe minimizimin e ndotjes nga asbesti, që është miratuar në vitin 2016 dhe ka hyrë në fuqi në vitin 2018)

141. AKUM-i duhet të hartojnë PSV-të për MS-në për të gjitha investimet, duke përcaktuar kriteret e shqyrtimit dhe pranimit dhe treguesit për monitorimin e performancës gjatë zbatimit. Kjo duhet të bëhet dhe të ndiqet edhe nga personeli i MS-së në AKUM. PSV-të duhet të përfshijnë:

- a. Shqyrtimin e një varianti të përditësuar të listës së kontrollit për procedurën e kontrollit të AKUM-it dhe përfshirjen e një kërkesë për VNM dhe gjithashtu të garantohet se deklarata zyrtare e marrë për shpronësimin e tokës dhe e lëshuar nga bashkia të jetë e verifikuar me kujdes.
- b. Kontrolli duhet të përfshijë: kontrollin e dokumenteve kadastrale, kontrollin fizik të terrenit, dhe kontrollin për zhvillimin e konsultimit publik, në mënyrë që të verifikohet përdorimi i tokës së nevojshme për investimin.
- c. Sa më poshtë duhet të jenë pjesë e dokumentacionit të propozimit:
 - i. Kontrolli do të përfshijë dokumentacionin kadastral zyrtar, inspektimin fizik me sy dhe dëgjuesën publike. Njerëzit do të informohen se ku do të kalojë tubacioni.
 - ii. Ndërmarrjet/bashkitë duhet të tregojnë nëse investimet do të ndikojnë përdorimin e aseteve/tokave nga pronarët informalë, do të sigurojnë kompensimin, dhe do të dokumentojnë kompensimin e siguruar për asetet e prekura.
 - iii. Ndërmarrjet/bashkitë duhet të tregojnë nëse investimet do të kërkojnë marrjen e përkohshme të tokës. Nëse po, marrëveshja me shkrim me pronarët e tokave duhet të përfshihet në propozim.

Përshkrimi i Veprimit	Burimi	#TLD	Përgjegjësia	Afati	Matësi i Zbatimit
Specialistë të kualifikuar Mjedisorë dhe Socialë (MS) punësohen në ekipin e shqyrtimit të projekt propozimeve në AKUM dhe ka buxhet të mjaftueshëm për forcimin dhe bashkërendimin e menaxhimit mjedisor dhe social.	VSMS		MIE AKUM	Sipas Efikasitetit	AKUM ka personel në njësinë e shqyrtimit me buxhet të caktuar për funksionet e reja.
PSV për MS-në për të gjitha investimet, që përcaktojnë kriteret e shqyrtimit dhe pranimit dhe treguesit për monitorimin e performancës gjatë zbatimit	VSMS		AKUM	Në momentin e hyrjes në fuqi	PSV-të e MS-së të miratuara Treguesit e raportuar çdo 6 muaj
Ndërmarrjet e Ujësjiellit marrin trajnim për pikëpamjet mjedisore dhe sociale që pasqyrojnë kërkesat e PSV-ve.	VSMS		SHUKALB personeli i MS-së në AKUM	Gjatë gjashtë muajve të parë pas hyrjes në fuqi, dhe më pas të paktën një herë në vit.	Ndërmarrjeve të Ujësjiellit u sigurohet trajnim
Hartohet procedurat e veprimit që trajtojnë menaxhimin e tubave me asbest në infrastrukturën e ujit, përfshirë edhe largimin e tubave me asbest.	VSMS		AKUM	Përpara fillimit të zbatimit të skemës së granteve për investimet në ujë	

Elemente të tjera të propozuara për të trajtuar rreziqet

142. FIP do të financojë AT si mbështetje për programin PpR. AT-ja duhet të hartohet me këshillim nga specialistët e MS-së në mënyrë që ndikimet mundshme të mëpasshme të MS-së, si mbrojtja e burimeve natyrore, marrja e tokës dhe puna me grupet e cenueshme dhe të disavantazuara, ndër të tjera, të merret në konsideratë. Komponenti i FIP-së do të mbështesë gjithashtu komunikimin dhe kontaktin me publikun lidhur me këto veprimtari, dhe kjo AT do të ofrohet në përputhje me planin e parashikuar të Angazhimit Mjedisor dhe Social (PAMS), Planin e Menaxhimit të Fuqisë Punëtore (PMFP) dhe Planin e Angazhimit të Palëve të Interesit (PAPI)

143. Për të plotësuar monitorimin e ecurisë dhe kënaqësinë e përfituesit lidhur me veprimtarinë e financuara në kuadër të fushave të rezultateve 2 dhe 3, duhet të hartohen tregues të angazhimit të qytetarëve. Për shembull, ndërmarrjet mund të zhvillojnë anketime të kënaqësisë së klientëve pasi të jetë kryer një investim dhe t'i raportojnë rezultatet e tij si pjesë e standardeve të tyre të ofrimit të shërbimit. Gjithashtu duhet të mbyllet cikli i marrjes së reagimeve pasi rezultatet e anketimit të jenë marrë nga ndërmarrja.

144. Si pjesë e zbatimit dhe verifikimit të investimit/protokolleve të verifikimit të TLD-ve për këto të fundit me ndikime të mundshme, duhet të përcaktohet kriteret e verifikimit (referenca i POM-së pritet të përgatitet nga Klienti). Procesi i sugjeruar: Një specialist nga AKUM duhet të kryejë inspektimin në terren për përputhshmërinë e marrjes së tokës për projektin dhe duhet të përgatisë një raport inspektimi (kjo duhet të pasqyrohet në PSV-të e tyre). Raportet e inspektimit duhet t'i dorëzohen organit të verifikimit të TLD-ve. Elementet e inspektimit duhet të përfshijnë: i) nëse ka zgjerim të tokës së projektit që nuk është në përputhje me projekt propozimin e investimit/dosjen e shpronësimit; ii) nëse metoda e marrëveshjes është në përputhje me procedurat e rëna dakord; dhe iii) nëse ka probleme me shembjen. Në ato raste ku konstatohet se kompensimi për marrjen e tokës nuk është bërë sipas legjislacionit për tokën, ose kur identifikohen probleme të papritura sociale në nënprojekt, AKUM-i duhet të punojë me Ndërmarrjen e UK-së/bashkinë përkatëse për të zgjidhur problemin sa më shpejt të jetë e mundur. Investimet me probleme të tilla nuk janë të pranueshme për financim PpR.

145. Rekomandim për forcimin e Procesit të Shpronësimit:

Tema	Masa për të përmirësuar performancën e sistemit
Rivendosja e pavullnetshme - zhvendosja fizike dhe ekonomike	Hartimi i PVR për kantierin e veçantë, pronarët informalë të ndërtesave do të marrin kompensim në të holla me kosto zëvendësimi dhe pagesa shtesë për shpërnguljen dhe shpenzimet tranzitore.
Procesi i planifikimit	PVR-të, Anketimet e Censurit dhe vlerësimet e ndikimit social dhe ekonomik përgatiten përveç kërkesave kombëtare.
Konsultimet Publike	Promovuesi konsultohet me publikun për çdo instrument të veçantë të rivendosjes.
Data e Fundit	Promovuesi konsultohet me publikun për këtë temë dhe shpjegon rëndësinë e saj.

Tema	Masa për të përmirësuar performancën e sistemit
Marrëveshjet e negociuara	Rregulluara në Legjislacionin Shqiptar Pronari ka 15 ditë për të informuar ministrinë kompetente për vendimin.
Vlera dhe afati i kompensimit	Promovuesi i projektit përlogarit koston e transaksionit në buxhetin e përgjithshëm.
Ofrohet banesë/strehim i përshtatshëm me siguri posedimi.	Zhvendosja fizike e PP-ve nuk parashikohet, dhe kjo pjesë nuk ka gjasa të zbatohet. Megjithatë, për çdo PVR, merret në konsideratë dhe trajtohet çdo zhvendosje e parashikuar.
Grupet e cenueshme	Promovuesi i projektit ofron asistencë ligjore dhe për rivendosjen
Ofrohet kompensim, rivendosje dhe të drejta në rast zhvendosjeje fizike.	Masat specifike përcaktohen në PVR
Mekanizmi i Ankesave	Promovuesi i projektit krijon një mekanizëm ankesash me dy shkallë, përfshirë një të brendshme dhe një të jashtme, përpara se PP-të t'i drejtohen drejtësisë, që është alternativa e fundit e mekanizmit të ankesave.
Asistencë shtesë për PP-të	Mbështetje gjatë ndërtimit dhe pas shpronësimit
Publikim i informacionit për publikun	Konsultime dhe publikime të tilla nuk janë të ndaluara dhe munden ose duhet të përfshihen si masa specifike.

Informacione për Planin e Mbështetjes së Zbatimit të Programit

146. Përputhshmëria me parimet themelore monitorohet si pjesë e mbështetjes për zbatimin nga ana e Bankës, përgjatë ciklit operacional. Ekipi i Bankës i ngarkuar me detyrën, monitoron performancën e Programit të PpR dhe zbatimin e sistemeve të MS-së të huamarrësve, që aplikojnë për Programin PpR, veçanërisht sa i përket sistemeve të veçanta apo masave për përforsimin e kapaciteteve për të cilat është rënë dakord me huamarrësin.

147. Kërkesat për Aftësitë e Ekipeve të ngarkuar me Detyrën lidhur me Zbatimin e Mbështetjes gjatë Programit PpR

Aftësitë e nevojshme	Numri i Stafit Javë	Numri i Udhëtimeve	Komentet
Zhvillimi Social	28	14	Stafi nga Selia Qendrore do të mbështesë konsulentin vendor
Mjedisi	28	14	

148. MIE/AKUM shpërndan raportet e ankesave nga Portali Kombëtar i Konsumatorëve dhe nga platforma e vet e ankesave dhe ERRU gjithashtu shpërndan raportet për ankesa të marra në kuadër të Programit.

149. Gjithashtu, AKUM do të ndajë dokumentacionin e tokës së marrë si pasojë e investimeve të bëra në kuadër të Programit dhe rastet kur individë që nuk kishin të drejta mbi tokën, por që kishin ndërtuar struktura mbi to dhe që ishin larguar si pasojë e veprimtarive të Programit, janë kompensuar në mënyrë të përshtatshme.

Seksioni V. Shtojca Mbështetëse dhe Dokumente Reference

Shtojca A e Përditësuar: Hartëzimi i Palëve të Interesit

Fusha e Rezultateve 1: Kuadër i Përforsuar Kombëtar, që do të përqendrohet në kuadrin e sektorit kombëtar dhe në politikat dhe programet kombëtare.

Emri	Aftësia për të ndikuar	Personi i kontaktuar	Metoda e kontaktit/pranisë
MIE	kuadri i sektorit kombëtar dhe politikat dhe programet kombëtare	Lindita Sotiri, Drejtor i Programeve të Zhvillimit në fushën e Ujësjetës dhe Kanalizimeve	Takime ballë për ballë dhe virtuale, email dhe telefonata
AKUM	politikat dhe programet e NU-ve	Alqi Blako Drejtor i Përgjithshëm i AKUM	Takime ballë për ballë dhe virtuale, email dhe telefonata
ERRU	NU-të dhe Konsumatorët	Ndriçim Shani Drejtor i ERRU	Takime ballë për ballë dhe virtuale, email dhe telefonata
KFW	kuadri i sektorit kombëtar dhe politikat dhe programet kombëtare	Përfaqësuesi për sektorin e ujit	Takime ballë për ballë dhe virtuale, email dhe telefonata
GIZ	kuadri i sektorit kombëtar dhe politikat dhe programet kombëtare	Përfaqësuesi për sektorin e ujit	Takime ballë për ballë dhe virtuale, email dhe telefonata
Fondi Shqiptar i Zhvillimit	kuadri i sektorit kombëtar dhe politikat dhe programet kombëtare	Përfaqësuesi për sektorin e ujit	Takime ballë për ballë dhe virtuale, email dhe telefonata
SHUKALB	Përmirësimi i menaxhimit në ndërmarrjet e ujësjetës dhe ndërmarrjet e ujërave të ndotura	Petrit Tare, President	Takime ballë për ballë dhe virtuale, email dhe telefonata
MFE	Kuadri i sektorit kombëtar dhe politikat dhe programet kombëtare	Gentjan Opre, Drejtor, Drejtoria e analizës dhe buxhetit	Takime ballë për ballë dhe virtuale, email dhe telefonata
SShÇE	Kuadri i sektorit kombëtar dhe politikat dhe programet kombëtare	Përfaqësuesi për sektorin e ujit	Takime ballë për ballë dhe virtuale, email dhe telefonata
BE	Kuadri i sektorit kombëtar dhe politikat dhe programet kombëtare	Përfaqësuesi për sektorin e ujit	Takime ballë për ballë dhe virtuale, email dhe telefonata

Fusha e Rezultateve 2: Efektshmëri dhe Qëndrueshmëri Financiare e Përmirësuar e Ndërmarrjeve të UK-së

Emri	Aftësia për të ndikuar	Person kontakti	Metoda e kontaktit/pranisë
MIE	Transferimi i subvencioneve operacionale të lidhura me treguesit e performancës me incentiva për pikësnyime të veçanta	Lindita Sotiri, Drejtor i Programeve të Zhvillimit në fushën e Ujësjetës dhe Kanalizimeve	Takime ballë për ballë dhe virtuale, email dhe telefonata
ERRU	Vlerësimi i performancës së ndërmarrjeve tek identifikohen mundësitë për përmirësim	Ndriçim Shani, Drejtor i ERRU	Takime ballë për ballë dhe virtuale, email dhe telefonata
MFE	Lidhja e caktimeve buxhetore me treguesit e performancës të MIE	Gentjan Opre, Drejtor, Drejtoria e analizës dhe buxhetit	Takime ballë për ballë dhe virtuale, email dhe telefonata
AKM	Miratimi i legjislacionit që kërkon plotësimin e standardeve të cilësisë së ujit	Kreu i Agjencisë, krerë të drejtorive të ndryshme, si Drejtoria e performancës mjedisore, drejtoria e licencimit, drejtoria e kontrollit dhe monitorimit	Takime ballë për ballë dhe virtuale, email dhe telefonata
Qeverisja Vendore (zyrat e Kryetarëve të Bashkisë)	Incentivat për performancë financiare të përmirësuar	Kryetarët përkatës të bashkive dhe kreu i shërbimeve të përgjithshme dhe atyre publike	Takime ballë për ballë dhe virtuale, email dhe telefonata
Ndërmarrjet e Ujësjetës (Inxhinierët, personeli i shërbimit të klientit)	Përmirësimi i performancës financiare të shoqërisë përmes efektshmërisë më të madhe sa i përket menaxhimit më të mirë të ujit	Drejtori teknik	Takime ballë për ballë dhe virtuale, email dhe telefonata
Familjet që nuk kanë ujë	Kërkesa për t'u bërë konsumatorë të pranuar të ofruesve të shërbimeve të ujit	Një përfaqësues i zgjedhur prej tyre	Takime ballë për ballë dhe virtuale, email dhe telefonata

Përfituesit	Pagesat e rregullta dhe kërkesa për shërbime të përmirësuara	Një përfaqësues i zgjedhur prej tyre	Takime ballë për ballë dhe virtuale, email dhe telefonata
Komuniteti Rom?	Kërkesë për vijimin e dialogut, sepse tema e furnizimit me ujë diskutohet gjerësisht në çdo dëgjese publike	Një përfaqësues i zgjedhur prej tyre	Takime ballë për ballë dhe virtuale, email dhe telefonata
Komuniteti Egjiptian?	Kërkesë për vijimin e dialogut, sepse tema e furnizimit me ujë diskutohet gjerësisht në çdo dëgjese publike	Një përfaqësues i zgjedhur prej tyre	Takime ballë për ballë dhe virtuale, email dhe telefonata
Grupet e Grave			Takime ballë për ballë dhe virtuale, email dhe telefonata
PRU (Profesionistët e Rinj të Ujit)	Ofrimi/sugjerimi i zgjidhjeve të qëndrueshme për menaxhim të përmirësuar bazuar në qasje të reja dhe teknologji të përmirësuara	Përfaqësuesi i tyre	Takime ballë për ballë dhe virtuale, email dhe telefonata
OJF-të e sektorit të ujit (SHUKALB)	Sugjerimi për qasjen dhe menaxhimin e përmirësuar, gjithashtu krahasuar me vendet e rajonit që kanë pasur sfida të ngjashme në të shkuarën	Kreu i SHUKALB	Takime ballë për ballë dhe virtuale, email dhe telefonata

Fusha e Rezultateve 3: Akses i Përmirësuar në Shërbime të Furnizimit me Ujë në Zonat Rurale

Emri	Aftësia për të ndikuar		
MIE	Sigurimi i incentivave për mbulim më të madh me furnizim me ujë në zonat rurale	Lindita Sotiri, Drejtor i Programeve të Zhvillimit në fushën e Ujësjetës dhe Kanalizimeve	Takime ballë për ballë dhe virtuale, email dhe telefonata
Qeverisja Vendore	Mbështetje për ndërmarrjet e ujësjetës për shtrirjen e shërbimeve të tyre në zonat rurale	Kryetarët përkatës të secilës bashki	Takime ballë për ballë dhe virtuale, email dhe telefonata
Ndërmarrjet e Ujësjetës	Zgjerimi dhe përmirësimi i shërbimeve	Kreu i ekipit teknik	Takime ballë për ballë dhe virtuale, email dhe telefonata
Familjet pa lidhje uji	Aplikimi për t'u bërë konsumator i rregullt në momentin që shërbimi ofrohet dhe nënshkrimi i kontratës së shërbimit	Përfaqësues i zgjedhur	Takime ballë për ballë dhe virtuale, email dhe telefonata
Përfituesit	Pagesat e rregullta për shërbimin dhe kërkesa e llogaridhënies nga ofruesit e shërbimit	Përfaqësues i zgjedhur	Takime ballë për ballë dhe virtuale, email dhe telefonata
Komuniteti Rom?	Kërkesë për zgjerimin e shërbimeve në zonat rurale	Përfaqësues i zgjedhur	Takime ballë për ballë dhe virtuale, email dhe telefonata
Komuniteti Egjiptian?	Kërkesë për zgjerimin e shërbimeve në zonat rurale	Përfaqësues i zgjedhur	Takime ballë për ballë dhe virtuale, email dhe telefonata
Grupet e Grave	Të grenë zërin për të mbështetur personat e cenueshëm pa shërbime ujësjetësi	Përfaqësues i zgjedhur	Takime ballë për ballë dhe virtuale, email dhe telefonata
Të Rinjtë?	Të grenë zërin për të mbështetur personat e cenueshëm pa shërbime	Përfaqësues i zgjedhur	Takime ballë për ballë dhe virtuale, email dhe telefonata

	ujësjellësi		
OJF-të e sektorit të ujit (SHUKALB)	Mbështetje për ndërmarrjet e ujësjellësit për të zgjeruar dhe përmirësuar shërbimet përmes ndarjes së përvojave.	Kreu i SHUKALB	Takime ballë për ballë dhe virtuale, email dhe telefonata

Shtojca B: Shembull i Formularit të Ankesës në Portalin Kombëtar të Konsumatorit



Sh.aj Ujësjellës Kanalizime Himarë

KREJU

RRETH NESH

PUNA JONË

SHËRBIME

NA KONTAKTONI

Ankesa

Faqja është duke u përditësuar. Format e kontaktit do të jenë shumë shpejt funksionale. Ju falënderojmë për mirëkuptimin.

Nuk jeni të kënaqur me shërbimet tona? Keni ankesa për furnizimin me ujë apo rrjetin e kanalizimeve? Ju lutemi te plotësoni formën më poshtë që të informohemi se çfarë nuk shkon mirë në mënyrë që të ndërhyjmë. Për ne është shumë e rëndësishme që abonentit të jetë i kënaqur. Do ta trajtojmë ankesën tuaj sapo të mundemi dhe do t'ju njoftojmë përkatësisht.

Nr. i Kontratës *

M F

Emri *

Mbiemri *

Rruga

Qyteti

Telefon *

E-mail *

Problem me: *

Ankesa Juaj *

Ngarko Foto

No file chosen

One file only.

10 MB limit.

Allowed types: gif jpg png.

Si funksionon?

Kur të klikoni butonin 'Dërgo', ky formular anekese ruhet në serverin tonë dhe njoftohemi nëpërmjet email. Ju gjithashtu do të merrni një email konfirmues. Ne do ta trajtojmë ankesën tuaj me prioritet dhe do t'ju njoftojmë për çdo veprim që do të ndërmarim nëpërmjet email, telefonit apo kontaktit në terren.

Na kontaktoni

Telefon: 0692521907

E-mail: ujesjellesi.himare@gmail.com

Facebook



Complaint

The site is being updated. Contact forms will be operational soon. Thank you for your understanding.

Not satisfied with our services? Have complaints about water supply or sewer network? Please fill out the form below to find out what is wrong with us to intervene. For us it is very important that the subscriber is satisfied. We will handle your complaint as soon as we can and let you know accordingly.

Nr. of the Contract *

☐ M ☐ F

Name *

Surname *

Street

town

Telephone *

Email *

Problem me. *

Your complaint *

Pëshkruaj problem në fjale...

Upload Photo

No file chosen

One file only.

10 MB limit.

Allowed types: gif jpg png.

Leave

How it works?

When you click the 'Submit' button, this complaint form is stored on our server and we are notified by email. You will also receive a confirmation email. We will treat your complaint as a priority and notify you of any action we will take by email, phone or on-site contact.

Contact us

Phone: 0692521907

E-mail: ujesjellesihimare@gmail.com

Facebook

Shtojca C: Plotësimi i Propozuar me Personel MS për Njësinë e Zbatimit të AKUM, Përshkrimi i Pozicionit

Plotësimi i Propozuar me Personel MS për Njësinë e Zbatimit të AKUM

Dy (2) specialistë mjedisorë dhe socialë për të kryer detyrat e mëposhtme në të gjitha bashkitë:

- Të ndërgjegjësojë bashkitë dhe ndërmarrjet e ujësjellësit lidhur me formularin e përditësuar të kontrollit, procesin e shqyrtimit, dhe rëndësinë e menaxhimit të rrezikut ndaj MS-së.
- Të lehtësojë seminarët me bashkitë që marrin Grante të Bazuara në Performancë, lidhur me identifikimin e rreziqeve mjedisore dhe sociale dhe fuqizimin e procesit të përgatitjes së projekteve në nivel bashkie, me qëllim sigurimin e kontrollit gjithëpërfshirës dhe lehtësimin e rreziqeve ndaj MS-së.
- Të kryejë vizita në terren dhe të mbështesë ndërmarrjet e ujësjellësit në nivel bashkie.
- Të kryejë vizita në terren për të kontrolluar në vend investimet për përputhshmëri me kërkesat e pranueshmërisë.
- Të ndihmojë në organizimin dhe lehtësimin e trajnimeve për menaxhimin e rreziqeve ndaj MS-së për stafin e ndërmarrjeve të ujësjellësit, përfshirë inxhinierët dhe stafin e shërbimit të konsumatorit.
- Të hartojë instrumentet, si Termat standarde të Referencës për përgatitjen e VNM-ve për investime bashkiake.
- Të këshillojnë për përfshirjen e menaxhimit të rrezikut ndaj MS-së në strategjitë, politikat dhe dokumentet e tjera të sektorit të ujit.
- Të kryejë detyra të tjera të caktuara nga kreu i njësisë, që lidhen me menaxhimin e rrezikut mjedisor dhe social të nevojshëm për zbatimin e suksesshëm të mandatit të AKUM-it.

Shqyrtimi i propozimit dhe mbikëqyrja:

- Të sigurohet që propozimet kontrollohen siç duhet lidhur me kërkesat e VNM-së dhe të marrjes/shpronësimit të tokës dhe që të përgatiten instrumentet e përshtatshme për menaxhimin e rrezikut ndaj MS-së.
- Të sigurohet që planet për ngritjen e kapaciteteve të shqyrtohen dhe të sigurohet që kërkesat për mbështetje me ngritjen e kapaciteteve në menaxhimin e rrezikut ndaj MS të plotësohen në mënyrë të efektshme që garanton cilësi dhe zbatim praktik.
- Të mbështetet përpunimi dhe përmirësimi i mëtejshëm i sistemit të menaxhimit të rrezikut ndaj MS-së.
- Të punohet me agjencitë e tjera për të forcuar kuadrin e menaxhimit të rrezikut ndaj MS-së.
- Të përgatiten progres raporte të rregullta dhe sipas afateve në përputhje me planin e punës dhe kërkesat e raportimit.
- Me qëllim menaxhimin më të mirë të rrezikut, nuk do të ndërmerret vetëm kontrolli forma i dokumentacionit kadastral, por edhe kontrolli fizik në terren dhe duhet të zhvillohen konsultime me publikun.

Kualifikimet dhe përvoja minimale

- Diplomë master në shkencë shoqërore, zhvillim komuniteti, antropologji apo një fushë të përafërt dhe/ose nivel të lartë arsimit (master ose doktoraturë) në inxhinieri mjedisorë, shkencë mjedisorë ose menaxhim të burimeve natyrore.

- Të paktën pesë vjet përvojë profesionale në fushë, përfshirë përvojë të aplikuar në sektorin privat për menaxhim rreziku ndaj MS-së, investime dhe politika të investimeve të qëndrueshme; dhe hartim e zhvillim trajnimi apo mënyrave të tjera të dhënies së njohurive për praktikat e mira të menaxhimit të rrezikut ndaj MS-së dhe/ose sigurimit të MS-së.
- Të paktën pesë vjet përvojë në menaxhimin e rreziqeve sociale, përfshirë: përfshirjen si p.sh., grupet e pakicave tradicionale, njerëzit që jetojnë me aftësi të kufizuara, përfshirjen gjinore, lehtësimin e konfliktit dhe arritjen e paqes, rivendosjen dhe/ose kompensimin për marrjen e pavullnetshme të tokës.
- Njohuri të politikave të MS-së në institucionet ndërkombëtare, përfshirë Bankën Botërore, GIZ dhe KfW.
- Njohuri të zhvillimit shoqëror, përfshirë projektet e zhvillimit të komuniteteve.
- duhet të ketë aftësi shumë të mira në hartim raportesh dhe komunikim me gojë.
- Duhet të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe aftësi bindëse gjatë prezantimeve, negociatave, si dhe për zgjidhjen e çështjeve të ndërlikuara.
- Duhet të ketë aftësi të forta ndërpersonale dhe të jetë i/e aftë të punojë si pjesëtar ekipi.
- Duhet të ketë njohuri për mekanizmat e trajtimit të ankesave dhe kuadrot e pjesëmarrjes së publikut dhe ato të qeverisjes vendore.

Shtojca D: Pyetësi i Kontrollit i Ndërmarrjes së Ujësjes dhe Bashkisë

PYETËSOR për Ndërmarrjet e Ujësjes, Programi “PpR për Ujin në Shqipëri”

Ju lutemi plotësoni pyetësin për Misionin në Shqipëri - Çështjet Mjedisore dhe Sociale.

Ndërmarrja e Ujësjes: _____

	PYETJE	PËRGJIGJE
1	Marrja e Tokës dhe Rivendosja	
1.1	A i merr kontrolli në konsideratë ndikimet në regjimet e ndryshme të pronësisë, përfshirë burimet e zakonshme të pronësisë, të drejtat zakonore apo tradicionale për përdorimin e tokës apo burimeve, ata që nuk kanë tituj pronësie apo pretendime të tjera që njihen, dhe të drejtat e Komuniteteve Vendore Tradicionale që Historikisht kanë Pasur më Pak Shërbime?	
1.2	A kërkojnë proceset identifikimin dhe lehtësimin e të gjitha ndikimeve të konsiderueshme që ndikojnë përdoruesit informale apo ata që kanë zënë tokën (ose burime të tjera)? Ju lutemi jepni shembuj të rasteve kur ka pasur ndryshim të planeve për të shmangur ndikimet e konsiderueshme.	
1.3	A ka struktura e NU-së një njësi apo persona të punësuar të cilët janë përgjegjës për të ndjekur çështjet e mundshme sociale në kuadrin e marrjes së tokës?	
1.4	A zbatohet ndonjë procedurë marrëveshje midis pronarit dhe NU-së në raste kur asetet ndërtohen në tokë private, si për shembull kontrata të marrjes së tokës, apo të përdorimit të saj, ose kontrata qiraje? A dokumentohen këto marrëveshje apo arrihen në nivel informal?	
1.5	A ka një mekanizëm ankesash për asetet që	

	PYETJE	PËRGJIGJE
	<p>merren? Nëse po, përshkruajeni atë. Cilat janë çështjet më të zakonshme që ngrihen? Pikat e kontaktit (telefon, email, faqe interneti?) A grumbullohen ankesat nga pika të ndryshme të pranimit të tyre? A përgatiten raporte që dokumentojnë ankesat gjatë një periudhe kohe? A ka afate për përgjigjen që i komunikohet personave të prekur? A ka njësi apo personel të Përkushtuar për këtë funksion? A ka buxhet për këtë funksion? Nëse po, sa është buxheti dhe a është i mjaftueshëm ai?</p>	
1.6	<p>A zotëron NU-ja pronësinë e zonave të mbrojtjes të përcaktuara në bazë të VKM Nr. 379 datë (25.5.2016)? A ka çështje me pronarët e tokave private apo me veprimtaritë private që mund të paraqesin ndikime të mundshme negative?</p>	
2	Burimet ujore dhe rrejtji i furnizimit me ujë	
2.1	<p>Sa burime ujore po përdoren? Ju lutemi specifikoni nëse janë burime nëntokësore ose sipërfaqësore. Gjithashtu specifikoni trupin më të aftër ujqor me emër dhe distancë.</p>	
2.2	<p>VKM Nr. 379 datë 25.5.2016, ndër të tjera rregullon zonat mbrojtëse përreth puseve ujore. Rregullorja përcakton tre zona mbrojtëse (zona tampon) nga pusi i ujërave nëntokësore apo depozitimet ujore në tokë. A po respektohen kriteret e përcaktimit të zonave? A zotëron NU-ja pronësinë ligjore të zonave të mbrojtjes të përcaktuara në bazë të VKM-së? A ka çështje me pronarët e tokave private apo me veprimtaritë private që mund të paraqesin ndikime të mundshme negative?</p>	
2.3	<p>A janë të pajisura burimet ujore me leje nga agjencia e basenit lumor duke iu referuar ligjit 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" dhe VKM-së Nr. 416, datë 13/05/2012 "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë,</p>	

	PYETJE	PËRGJIGJE
	formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit të vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e Lejes për përdorimin e burimeve ujore”?	
2.4	Llojet e kimikateve të përdorura për trajtimin dhe/ose dezinfektimin e ujit përpara furnizimit.	
2.5	Sa shpesh matet cilësia dhe nga cili laborator?	
2.6	Lloji i tubave të përdorur dhe në cilën përqindje të sistemit ekzistues të ujësjellësit <ul style="list-style-type: none"> a. Beton b. Azbest beton c. Gizë d. PE / plastikë e. Të tjera 	
3	Mjedisi, Shëndeti dhe Siguria	
3.1	A ekziston një kuadër ligjor që trajton dhe promovon sigurinë në vendin e punës? Ju lutemi përshkruani dhe ofroni dokumente nëse është e mundur. Si i zbaton në praktikë NU-ja kërkesat dhe direktivat e ligjeve për sigurinë dhe shëndetin:	
3.2	A ka masa të detyrueshme që t'i detyrojnë kontraktorët dhe operatorët e ndërmarrjes që t'i përdorin pajisjet dhe objektet në mënyrë të tillë që të mbrojnë individët dhe komunitetet?	
3.3	A ka masa për mbrojtjen e individëve dhe mjedisit nga efektet e materialeve të rrezikshme apo toksike që përdoren në proceset e ndërtimit dhe prodhimit, apo mbetje që krijohen si nënprodukt i operacioneve ndërtimore ose të objekteve? Ku renditen këto? Si u këto komunikohen ndërmarrjeve?	
3.4	A ka masa që ndihmojnë në mbrojtjen e individëve dhe/ose komuniteteve nga dhuna, kanosja, ngacmimi, aktiviteti kriminal apo ndërveprime të tjera negative me	

	PYETJE	PËRGJIGJE
	kontraktorët, punëtorët, operatorët apo punonjës të tjerë që lidhen me një aktivitet projekti? Si u komunikohen këto ndërmarrjeve?	
3.5	A ka masa për mbrojtjen e individëve dhe/ose komuniteteve nga dhuna, kanosja, ngacmimi, aktiviteti kriminal, apo ndërveprime të tjera negative me kontraktorët, punëtorët, operatorët apo punonjës të tjerë që lidhen me një aktivitet projekti? Ku renditen këto? Si u komunikohen këto ndërmarrjeve?	
3.6	A ka mekanizëm ankimi për punonjësit? Nëse po, ju lutemi përshkruani procesin për trajtimin e ankesës. Cilat janë çështjet më të zakonshme që ngrihen? Pikat e kontaktit (telefon, email, faqe interneti?) A përgatiten rregullisht raportet që dokumentojnë ankesat? A grumbullohen ankesat nga pika të ndryshme të pranimit të tyre? A është i qartë afati i kthimit të përgjigjet për punonjësit? A ka një njësi apo staf të posaçëm për këtë funksion? A ka buxhet për këtë funksion? Nëse po, sa është buxheti dhe a është i mjaftueshëm ai?	
3.7	A po merret në konsideratë zgjerimi i rrjetit ekzistues dhe nëse po: A ka zona të mbrojtura, pyje apo zona natyrore që mund të ndikohen nga zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit?	
4	Qasja Sociale	
4.1	Në rast identifikimi të defekteve në rrjetin e ujësjellësit, klasifikuar si risk potencial për ndotjen e ujit ose ndërprerjen e shërbimit të furnizimit me ujë, a janë të informuar klientët e prekur? Si plotësohet procedura e njoftimit të publikut?	
4.2	A ka një mekanizëm ankimi/ankesash për klientët apo publikun e gjerë? Nëse po, përshkruajeni atë. Cilat janë çështjet më të	

	PYETJE	PËRGJIGJE
	zakonshme që ngrihen? Pikat e kontaktit (telefon, email, faqe interneti?) A grumbullohen ankesat nga pika të ndryshme të pranimit të tyre? A përgatiten rregullisht raportet që dokumentojnë ankesat? Ju lutemi përshkruani procesin e trajtimit të ankesave, përfshi edhe afatin kohor të hapave. A ka një njësi apo staf të posaçëm për këtë funksion? A ka buxhet për këtë funksion? Nëse po, sa është buxheti dhe a është i mjaftueshëm ai?	
4.3	A ka ndonjë grup social që mund të konsiderohet i cenueshëm në kontekstin e aksesit në shërbimet e ujit apo shlyerjes së faturave të ujit?	
4.4	A ka politika lehtësuese që zbatohen për kategoritë sociale që nuk mund t'i përballojnë faturat e ujit? Nëse po, si rregullohet kjo? A ka ndonjë kuadër rregullator që e mbron këtë grup interesi?	
4.5	Nëse hasen gjetje rastësore apo objekte të trashëgimisë kulturore gjatë një projekti investimi, cilat procedura ndiqen? Ju lutemi jepni shembuj të një situatë të kohëve të fundit.	
4.6	A ka ndryshime të lidhur me llojin e punës që kryejnë burrat dhe gratë në ndërmarrjen e ujësjellësit? Cilat mendoni ju se janë problematikat, nëse ka, brenda ndërmarrjes së ujësjellësit dhe/ose vendit, lidhur me punësimin e grave në role teknike në sektorin e ujit?	
4.7	A mendoni se ka ndonjë risk mjedisor apo risqe të tjera lidhur me heqjen e lidhjeve të paligjshme të ujit, zëvendësimin e matësve, apo zgjerimin e shërbimit të ujit në zonat rurale?	
4.8	A dëshironi të ndani ndonjë gjë tjetër me ne?	

Pyetësi u plotësua nga:

Emër Mbiemër	Pozicioni në NU

Shtojca E: Palët e konsultuara gjatë përgatitjes së VSMS-së

Emri	Data/Vendi	Pozicioni	Emri i Palës së Interesit
<i>Lindita Sotiri</i>	08/11/2019 13/12/2019 17/12/2019 Tiranë, Shqipëri	Drejtor i Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit në fushën e Ujësjetës dhe Kanalizimeve	MIE
<i>Ndriçim Shani</i>	04/11/2019 Tiranë, Shqipëri	Kryetar i ERRU	ERRU
<i>Afërdita Mamaj</i>	21/11/2019 Tiranë, Shqipëri	Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Teknik	AKUM
<i>Valdete Ballhysa</i>	19/11/2019 Tiranë, Shqipëri	Anëtar i Drejtorisë së Kontrollit Teknik	AKUM
<i>Nadire Cenga</i>	20/11/2019 Tiranë, Shqipëri	Drejtor i Koordinimit të Statistikave dhe Informacionit	AKUM
<i>Athanas Karaj</i>	17/12/2019 15/01/2020 Tiranë, Shqipëri	Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë Rregullatore dhe të Përputhshmërisë në Turizëm dhe Mjedis	MTM
<i>Evis Melanoshi</i>	20/12/2019 Tiranë, Shqipëri	Shef i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis	AKM
<i>Kleant Semema</i>	20/12/2019 Tiranë, Shqipëri	Specialist i Lejeve Mjedisore	AKM
<i>Luan Dervishi</i>	06/11/2019 Elbasan, Shqipëri	Drejtor i NU Elbasan	NU Elbasan
<i>Irland Sina</i>	06/11/2019 Elbasan, Shqipëri	Zëvendës Kryetar Bashkie	Bashkia Elbasan
<i>Lulzime Dama</i>	06/11/2019 Elbasan, Shqipëri	Krye Inxhinierë	NU Elbasan
<i>Migena Paja</i>	06/11/2019 Elbasan, Shqipëri	Burimet njerëzore	NU Elbasan
<i>Rovena Halili</i>	06/11/2019 Elbasan, Shqipëri	Koordinatorë projekti	NU Elbasan
<i>Arjola Memetaj</i>	06/11/2019 Elbasan, Shqipëri	Drejtoreshë e Drejtorisë të Tregtisë	NU Elbasan
<i>Alketa Saraci</i>	06/11/2019	Koordinatorë e Ankesave dhe	NU Elbasan

	Elbasan, Shqipëri	Pretendimeve	
<i>Jorida Muho</i>	07/11/2019 Gjirokastrë, Shqipëri	Zëvendës Kryetar Bashkie	Bashkia Gjirokastrë
<i>Nelson Sejdo</i>	07/11/2019 Gjirokastrë, Shqipëri	Krye Inxhinier	NU Gjirokastrë
<i>Iverta Muho</i>	07/11/2019 Gjirokastrë, Shqipëri	Drejtores e Drejtorisë të Tregtisë	NU Gjirokastrë
<i>Gabriele Lama</i>	15/01/2020 Tiranë, Shqipëri	Drejtues i Ujit të Pijshëm dhe Shërbimeve Sanitare të Orientuara nga Konsumatori dhe Performanca	Zyrat e GIZ, Tiranë
<i>Monika Vejseli</i>	15/01/2020 Tiranë, Shqipëri	Specialist e Ujit të Pijshëm dhe Shërbimeve Sanitare të Orientuara nga Konsumatori dhe Performanca	Zyrat e GIZ, Tiranë
<i>Kasem Bejko</i>	11/02/2020 Durrës, Shqipëri	Zëvendës Drejtor	NU Durrës
<i>Florian Mustafaraj</i>	11/02/2020 Durrës, Shqipëri	Drejtor i NjZB-së	AKUM
<i>Lorenc Facja</i>	11/02/2020 Durrës, Shqipëri	Drejtor teknik	NU Durrës
<i>Olsen Cavalli</i>	11/02/2020 Durrës, Shqipëri	Inxhinier Elektrik	NU Durrës
<i>Danjela Novo</i>	11/02/2020 Durrës, Shqipëri	Koordinator i projektit	NU Durrës
<i>Gentian Kullolli</i>	12/02/2020, Belsh, Shqipëri	Drejtor teknik	NU Belsh
<i>Marenglen Bali</i>	12/02/2020, Belsh, Shqipëri	Zëvendës Drejtor	NU Belsh
<i>Endri Pepa</i>	12/02/2020, Belsh, Shqipëri	Drejtor i Përgjithshëm	NU Belsh

Shtojca F: Përmbledhjet e konsultimeve të VSMS-së

Do të plotësohen pas bërjes publike të VSMS-së dhe pasi të jenë zhvilluar konsultimet.